 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



UNITED NATIONS
ALBANIA




KATALOGU I PRAKTIKAVE MË TË MIRA NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Korrik 2020



 **PARTNERËT SHQIPËRI**
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



K A T A L O G U
I PRAKTIKAVE MË TË MIRA
NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE
TË KUJDESIT SHOQËROR

Korrik 2020

© 2020 nga **Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim**. Të gjitha të drejtat të rezervuara.



Ky katalog është përgatitur nga **Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim** me porosi të **Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP)**, në kuadër të Projektit **“Askush Të Mos Mbetet Pas”**, që mbështetet nga **Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)**. Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të UNDP-së në Shqipëri apo Kombeve të Bashkuara.

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	6
“Tungjatjeta... Jetë”	8
Shërbime për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore	10
Qendër Komunitare Multifunkionale “Për Familjen” (QKM “Për Familjen”).....	12
Shërbime shoqërore për gjithë ciklin e jetës së personit me aftësi të kufizuara	14
Shërbimi i Strehimit Emergjent të Sigurt.....	16
Programi i Autonomisë Personale dhe Sociale për Personat me Aftësi të Kufizuara	18
Qendra Ditore “Jetë në Zhvillim” Arrameras	20
Alternativa të përkujdesit mbasdite për fëmijët e nënave viktimat trafikimi dhe viktimat të dhunës në familjes “Shtëpia e Gjyshes/Shtëpia Tjetër”	22
Qendra e Zhvillimit Lushnje.....	24
Shërbimi kundër Dhunës me Bazë Gjinore	26
Shtëpi Mikpritëse “Santa Maria”	28
Shërbim Komunitar	30
Qendra e shërbimeve me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara	32
Qendra Ditore “Shpresa e Re”	34
Qendër Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuara	36

HYRJE

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), që prej vitit 2017 ka filluar zbatimin e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush Të Mos Mbetet Pas”, i cili po mbështet zbatimin e vizionit të ri të sektorit të shërbimeve shoqërore në Shqipëri, në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe aspiratat e vendit drejt integritimit në Bashkimin Evropian. Një ndër rezultatet e Programit “Askush Të Mos Mbetet Pas” përqendrohet tek mbështetja e bashkive në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në mënyrë më efektive dhe që promovojnë përfshirjen sociale. Për të përmbushur këtë synim, Programi do të kontribuojë drejt rritjes së kapaciteteve të bashkive në ofrimin e shërbimeve sociale dhe për të përshkallëzuar ato shërbime sociale që kanë rezultuar të efektshme.

Për këtë arsye, Programi ndërmori një nismë për identifikimin dhe promovimin e praktikave më të mira në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, e cila u realizua nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim.

Praktikat më të mira u përzgjedhën gjatë periudhës nëntor 2019-shkurt 2020, përmes një procesi të hapur aplikimi ku rreth 200 ofrues publikë dhe jo-publikë të shërbimeve të kujdesit shoqëror në të gjitha bashkitë e vendit, të identifikuar nëpërmjet bazës së të dhënave të Shërbimit Social Shtetëror, u ftuan të aplikojnë me praktikatat e tyre të shërbimit për individë, familje dhe grupe në nevojë.

Thirrja për shprehje interesi u shpërnda gjerësisht nëpërmjet mjeteve të komunikimit online dhe u dërgua me email te ofruesit publikë dhe jo-publikë të shërbimeve të kujdesit shoqëror të identifikuar në të gjithë territorin e vendit, si dhe në 61 bashkitë. Në përfundim të procesit të aplikimit, u morën 30 shprehje interesi nga ofrues publikë dhe jo-publikë (OJF), prej të cilave u përzgjedhën 15 praktikatat më të mira për të qënë pjesë e këtij katalogu.

Përzgjedhja u bë bazuar në përmbushjen e disa kriterëve të paracaktuara nga ekspertët të përfshirë në këtë nismë, të ndarë në dy kategori: (1) Shërbimi si pjesë e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror; (2) Cilësia dhe përshtatshmëria e shërbimit. Kriteret kryesore të vlerësimit përfshijnë: (i) shërbimi është pjesë e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror që ofrohet në bashki dhe adreson një prioritet të dokumentuar, (ii) shërbimi ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe të dukshëm mbi popullatën e targetuar, (iii) shërbimi ka elementë inovatorë dhe ka arritur të bëjë bashkë aktorë të ndryshëm (bashkinë, shoqërinë civile dhe përfituesit), (iv) krijon mundësinë për përsëritje të menjëhershme apo ngritje në bashki të tjera, (v) ofrimi i shërbimit ka dhënë rezultate të qarta dhe të matshme, (vi) shërbimi respekton faktin që individët janë përgjegjës për jetën e tyre dhe i nxit e i inkurajon ata që të marrin vendime për jetën e tyre, etj.

Praktikat e përzgjedhura, të prezantuara më poshtë në këtë katalog janë:

K A T A L O G U
I PRAKTIKAVE MË TË MIRA
NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE
TË KUJDESIT SHOQËROR

OFRUESI I SHËRBIMIT	EMRI I SHËRBIMIT	BASHKIA KU OFROHET SHËRBIMI
World Vision Albania, Bashkia Librazhd dhe Bashkia Dibër	Tungjatjeta... Jetë	Bashkitë Librazhd dhe Dibër
Forumi i Gruas Elbasan	Shërbime për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore	Bashkia Elbasan
Bashkia Shkodër	Qendër Komunitare Multifunksionale "Për Familjen"	Bashkia Shkodër
Shoqata "Ndihmoni Jetën"	Shërbime shoqërore për gjithë ciklin e jetës së personit me aftësi të kufizuara	Bashkia Tiranë
Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS	Shërbimi i Strehimit Emergjent të Sigurt	Bashkia Tiranë
Down Syndrome Albania	Programi i Autonomisë Personale dhe Sociale për Personat me Aftësi të Kufizuara	Bashkia Tiranë
Caritas Shqiptar	Qendra Ditore "Jetë në Zhvillim" Arrameras	Bashkia Fushë Krujë
Organizata "Të Ndryshëm & Të Barabartë"	Alternativa të përkujdesit mbase për fëmijët e nënave viktime trafikimi dhe viktime të dhunës në familje "Shtëpia e Gjyshes/ Shtëpia Tjetër"	Bashkitë Tiranë, Kamëz, Elbasan, dhe Shkodër
Bashkia Lushnje	Qendra e Zhvillimit Lushnje	Bashkia Lushnje
Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë"	Shërbimi kundër Dhunës me Bazë Gjinore	Bashkia Shkodër
Shoqata Komuniteti Papa Xhovani i XXIII	Shtëpi Mikpritëse "Santa Maria"	Bashkia Shkodër
Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën	Shërbim Komunitar	Bashkia Tiranë
Bashkia Durrës	Qendra e shërbimeve me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara	Bashkia Durrës
Fondacioni OAZ	Qendra Ditore "Shpresa e Re"	Bashkia Mat
Bashkia Pogradec & Zyra Vendore Arsimore Pogradec	Qendër Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuara	Bashkia Pogradec

Emri i Shërbimit

“TUNGJATJETA... JETË”

Ofruesi i Shërbimit

World Vision Albania, Bashkia Librazhd dhe Bashkia Dibër

Informacion Kontakti

Adresa: Rruga Skënderbej, Ndërtesa Gurten, Kati 2, Tiranë

Telefon: +355 (0) 4 2419601

Email: info@tungjatjeta.al

Webpage: www.tungjatjeta.al & www.worldvision.al

Përshkrimi i Shërbimit

“Tungjatjeta... Jetë” është një shërbim i specializuar lëvizës që u ofrohet fëmijëve me aftësi të kufizuara në shtëpi, në zonat e thella rurale të Shqipërisë. Koncepti Aftësi e Kufizuar bazohet në përkufizimin e modelit biopsikosocial, model i cili është pjesë përbërëse e reformës së shërbimeve për aftësinë e kufizuar në legjislatonin shqiptar. Një Njësi Lëvizëse që ka në përbërjen e saj një ekip profesionistësh, të pajisur me aftësitë dhe infrastrukturë të nevojshme, ofron shërbime cilësore pa pagesë për fëmijët me aftësi të kufizuara në vendin ku ata jetojnë (shtëpi). Shërbimi ofrohet bazuar në një Plan Zhvillimi Individual (PZHI), i cili hartohet pas vlerësimit të nevojave të fëmijës dhe familjes së tij, bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të funksionalitetit, në bashkëpunim me specialistë të tjerë që e njohin apo e kanë në përgjegjësi funksionale rastin e fëmijës dhe familjes dhe i dakordësuar me kujdestarin e fëmijës. Njësia lëvizëse ofron shërbim një herë në javë në shtëpinë e çdo fëmije, i cili/e cila përfiton mesatarisht dy seanca në javë, ku çdo seancë zgjat 60 minuta, nga të cilat 45 minuta specialisti ia kushton

terapisë me fëmijën dhe 15 minuta aftësimi të prindit për të realizuar ushtrime të thjeshta në vijim të terapisë. Paralelisht, prindi përfiton një herë në muaj një seancë këshillimi për fuqizimin e mekanizmave të tij në përballimin e situatës në të cilën gjendet. Kohëzgjatja e shërbimit për fëmijën në shtëpi varet nga niveli i vështirësisë dhe barrierat që has, për të zhvilluar të gjithë potencialin e tij/saj.

Profesionistët që ofrojnë shërbimin

Shërbimi lëvizës “Tungjatjeta..Jetë” ofrohet nga një ekip multifunksional i përbërë nga 2 psikologë, 2 punonjës socialë, 2 logopedë, dy 2 fizioterapistë dhe një 1 menaxher projekti.

Historiku i zhvillimit të shërbimit

World Vision Albania (WVA) është një organizatë zhvillimi komunitare, e krishterë, humanitare dhe avokatie. Në vitin 2018, WVA realizoi studimin e parë kombëtar mbi prevalencën e aftësisë së kufizuar, që tregoi se në Shqipëri ka rreth 70 mijë fëmijë me aftësi të kufizuara (10.4%) dhe 92% e tyre nuk kanë akses në shërbimet e specializuara. Në këto kushte, në qershor 2017, WVA prezantoi programin social “Tungjatjeta... Jetë” dhe në prill 2018 i dha jetë programit në bashkinë Librazhd e më tej, në prill 2019 në bashkinë Dibër.

Inovacioni

Kombinimi i disa elementëve, si: bashkë-krijimi i shërbimit me institucionet vendore; shërbimi në zona rurale dhe më të vështira për të ndërhyrë; përfshirja e familjes/kujdestarëve si aktorë kyç në shërbim; investimi në kapacitetet e specialistëve dhe vëmendja ndaj mirëqenies së tyre emocionale e bëjnë “Tungjatjeta..Jetë” një model inovator dhe lehtësisht të zbatueshëm. Në kushtet e pandemisë Covid - 19 shërbimi sollti risi në ofrimin e ushtrimeve dhe këshillave online bazuar në Planin e Zhvillimit Individual dhe ndërkohë që Shqipëria po përshtatet me normalitetin e ri, ekipet lëvizëse po fillojnë të praktikojnë modelin e “Terapisë në oborr” për të vijuar me ofrimin e shërbimit në familje.

Avantazhet

Avantazhi kryesor i modelit është ofrimi i shërbimit të specializuar në familje për fëmijët me aftësi të kufizuara që jetojnë në zona të thella rurale, të cilët për shkak të distancës nga vendi i banimit e kanë të pamundur marrjen e shërbimit në qendra multifunkionale/komunitare. Një tjetër avantazh përbën fakti që fëmija nuk trajtohet në mënyrë të veçantë, por punohet me të gjithë elementët e trekëndëshit themelor që ndikojnë në jetën e fëmijës: fëmijë, familje, komunitet.

Rezultatet

Që prej muajit prill 2018 e deri më sot, 84 fëmijë (32 vajza dhe 52 djem) me aftësi të kufizuara të moshës 3-18 vjeç kanë marrë 4545 seanca shërbimi të specializuara në fushën e fizioterapisë, logopedisë dhe terapisë së zhvillimit; 136 familjarë (90 femra dhe 46 meshkuj) të fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë marrë 1,025 seanca këshillimi nëpërmjet të cilave janë informuar dhe mbështetur emocionalisht dhe kanë rritur aftësitë e tyre në zhvillimin e potencialit të fëmijëve dhe 6 fëmijë (4 vajza dhe 2 djem) të moshës 9-13 vjeç janë përfshirë dhe ndjekin rregullisht institucionet arsimore. Për më shumë informacion mbi përmirësimin e fëmijëve përfitues të shërbimit referohuni linkut: <https://www.worldvision.al/hapat-e-pare-0>.

Qëndrueshmëria

Shërbimi është ngritur në bashkëpunim me Bashkinë Librazhd dhe Bashkinë Dibër dhe funksionon si një njësi brenda strukturave përgjegjëse për shërbimet sociale në këto bashki, duke krijuar kështu një model për ofrimin e shërbimit lëvizës komunitar për fëmijët me aftësi të kufizuara. Një tjetër element i qëndrueshmërisë është fakti që, disa bashki kanë përzgjedhur të aplikojnë për Fondin Social me këtë model dhe e kanë fituar atë.

Bashkëpunimi me aktorë të tjerë

Shërbimi funksionon me vendim të Këshillave të Bashkive Librazhd dhe Dibër dhe Këshillit të Qarkut për ofrimin e shërbimit në zonë.

Mundësia për përsëritje

Baza ligjore, e cila buron nga legjislati në fuqi për shërbimet shoqërore është element i rëndësishëm që lehtëson përsëritjen e modelit. World Vision Albania zotëron të gjithë paketën për ngritjen dhe funksionimin e modelit “Tungjatjeta...Jetë”, si përshkrimet e punës, paketën e trajnimeve, databazat e përfituesve, forma dokumentesh të shërbimit, forma e Planit Individual të Zhvillimit, plan monitorimi, etj.

KATALOGU I PRAKTIKAVE MË TË MIRA NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR



Emri i Shërbimit

SHËRBIME PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE

Ofruesi i Shërbimit

Forumi i Gruas Elbasan (FGE)

Informacion Kontakti

Adresa: Lagjja "Luigj Gurakuqi", rruga 11 Nëntori, Pallati 70, Elbasan

Telefon: +355(0) 69 6511674

Email: forumigruaselbasan1991@gmail.com

Webpage: www.forumigruaselbasan.org

Përshkrimi i Shërbimit

Forumi i Gruas Elbasan ofron shërbime të tipit komunitar, rezidencial e të specializuar pa pagesë për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në nivel rajonal e kombëtar. Shërbimi përfshin: (1) Qendër Këshillimi nëpërmjet linjës telefonike dhe ballë për ballë për asistencë dhe trajtim psikologjik; shërbim social e mjekësor; informim, referim dhe ndërmjetësim në strukturat publike dhe jo-publike; (2) Qendër Ditore Kujdesi ose Strehëz e Emergjencave, që ofron strehim nga pak orë deri në 2-3 ditë, në pritje të marrjes së Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM); (3) Studio Avokatore e cila ofron informacione e konsulencë ligjore falas; hartim

të akteve juridike drejtuar gjykatës për fillimin e çështjeve gjyqësore apo drejtuar institucioneve publike për sigurimin e informacionit të nevojshëm për proçes gjyqësor; përfaqësim në Gjykatë të të mbijetuarve të dhunës në familje; (4) Fushata ndërgjegjësimi në komunitete; (5) Rritje të kapaciteteve të profesionistëve të shërbimeve sociale, shëndetësore dhe policisë. Përveç punës individuale me përfituesit për fuqizimin psiko-social dhe ligjor, stafi i FGE realizon takime periodike në grupe, sesione fuqizuese që kontribuojnë në fuqizimin e të mbijetuarave për të thyer zinxhirin e dhunës. Koha mesatare e përfshirjes në shërbim të një përfituesi është një vit.

Profesionistët që ofrojnë shërbimin

Shërbimi ofrohet nga një ekip multidisiplinar i përbërë nga 2 punonjës socialë, 1 psikologe dhe 1 avokate.

Historiku i zhvillimit të shërbimit

FGE është krijuar në vitin 1991 si degë e Forunit të Pavarur të Gruas Shqiptare me qëllim mbrojtjen e të drejtave të grave dhe arritjen e barazisë gjinore përmes programeve të edukimit, ndërgjegjësimit, advokimit; shërbimeve psiko-social-ligjore për dhunën dhe shërbimeve të tjera alternative. Në vitin 1999, kur dhuna në familje në Qarkun e Elbasanit si kudo në Shqipëri ishte shumë e pranishme, u ngrit qendra e këshillimit për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Inovacioni

FGE është ofruesi i parë dhe i vetëm publik dhe jo-publik në Qarkun e Elbasanit që ofron shërbime të integruara për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, të cilat përfshijnë edhe strehëzën e emergjencave.

Avantazhet

Ofrimi i tre shërbimeve: (1) këshillimi psikologjik, (2) këshillimi ligjor dhe (3) strehëza e emergjencës (e vetmja në Qarkun

e Elbasanit), e kombinuar me fushatat e ndërgjegjësimit, si dhe puna e vazhdueshme në terren në çdo njësi të qarkut Elbasan me anëtarët e komunitetit dhe profesionistët lokalë, nga njëra anë rrit besueshmërinë ndaj shërbimit duke ndikuar pozitivisht në rritjen e numrit të përfituesve të shërbimeve dhe nga ana tjetër mundëson ri-integrimin e përfituesve në shoqëri.

Rezultatet

Që prej fillimeve të tij, shërbimi numëron një numër prej 19,086 përfituesish, prej të cilëve 12,369 kanë marrë këshillime psiko-sociale ballë për ballë dhe në telefon, 6,720 kanë përfituar këshillim ligjor dhe 254 përfituesve u është ofruar akomodim në qendrën e kujdesit ditor të emergjencës. Të ndarë sipas grupmoshave, 27% e përfituesve janë nën 25 vjeç, 55% janë të grupmoshës 25-45 vjeç, dhe 18% i përkasin grupmoshës mbi 45 vjeç. Mesatarisht 50 përfitues largohen nga shërbimi çdo vit të fuqizuar/ri-integruar në shoqëri.

Qëndrueshmëria

Për 20 vjet shërbimi është mbështetur në mënyrë të qëndrueshme me të gjithë komponentët e tij nga donatorë të ndryshëm, ku Qeveria Suedeze është donatori strategjik për mbi 18 vjet. Financimi nga shteti, në përputhje me bazën ligjore ekzistuese, do të ishte një kontribut i rëndësishëm për qëndrueshmërinë e mëtejshme të shërbimit.

Bashkëpunimi me aktorë të tjerë

Në bashkëpunim me strukturat e pushtetit vendor në Qarkun Elbasan (7 bashkitë e Qarkut, Këshilli i Qarkut, Drejtoria Vendore e Policisë, Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik, Zyra Vendore Arsimore), FGE ka ngritur Rrjetin Rajonal për trajtimin e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, një mekanizëm që bën të mundur kombinimin e shërbimeve sociale të ofruara nga OJF-të dhe shërbimeve ekonomike të ofruara nga institucionet shtetërore. Ky rrjet do të veprojë derisa mekanizmat e referimit të dhunës në familje do të ngrihen dhe do të funksionojnë në përputhje me kërkesat ligjore në çdo bashki. Në vitin 2018 FGE ngriti dhe bëri funksional mekanizmin e referimit të rasteve të dhunës në Bashkinë Belsh.

Mundësia për përsëritje

Eksperienca e FGE ka kontribuar në ngritjen e këtij lloji shërbimi dhe në tre qytete të tjera të Shqipërisë, si: në Durrës nga Shoqata e Grave me Probleme Sociale, në Shkodër nga Shoqata Gruaja tek Gruaja dhe në Dibër nga Shoqata Agritru-Vizion. Është në objektivin e FGE që ky shërbim të ngrihet në çdo qytet të Qarkut Elbasan, me qëllim krijimin e lehtësirave të mbijetuarve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

KATALOGU I PRAKTIKAVE MË TË MIRA NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR



Emri i Shërbimit

QENDËR KOMUNITARE MULTIFUNKSIONALE “PËR FAMILJEN” (QKM “PËR FAMILJEN”)

Ofruesi i Shërbimit

Bashkia Shkodër

Informacion Kontakti

Adresa: Bulevardi Mehmet Pashë Plaku, 4001, Shkodër

Email: sherbimetsociale@bashkiashkoder.gov.al

Webpage: www.bashkiashkoder.gov.al

Facebook: Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik-Shkodër

Përshkrimi i Shërbimit

QKM “Për Familjen” ofron shërbime të integruara që synojnë të përmirësojnë kushtet social-ekonomike të familjeve, kryesisht të komunitetit rom dhe egjiptian, por edhe të anëtarëve të varfër dhe të izoluar të komuniteteve të tjera. Qëllimi i shërbimit është fuqizimi dhe integrimi i këtyre familjeve në shoqëri. Shërbimet realizohen përmes një sistemi të integruar të shërbimeve shumësektoriale me bazë në komunitet dhe përfshijnë: (1) mbrojtjen sociale për përmirësimin e situatës social-ekonomike të familjeve dhe individëve duke trajtuar dhe ofruar mbështetje për të gjithë anëtarët e familjes sipas planeve të ndërhyrjes individuale; (2) ndihmën ligjore dhe regjistrimin në gjendjen civile; (3) integrimin e fëmijëve në sistemin arsimor nëpërmjet identifikimit, regjistrimit në shkollë, transportit dhe shoqërimit për të shkuar në shkollë, pagesave të tarifave të kopshteve dhe çerdheve dhe sigurimit të mjeteve didaktike; (4) rritjen e aksesit në shërbimet shëndetësore duke lehtësuar realizimin e vizitave shëndetësore dhe analizave laboratorike, pajisjen

me karta shëndetësore dhe rimbursimin e medikamenteve; (5) mundësi punësimi dhe formimi profesional nëpërmjet referimit dhe lehtësimit për të përfituar nga programet e nxitjes së punësimit dhe formimit profesional; (6) strehimin dhe integrimin urban nëpërmjet mbështetjes për të përfituar nga programet e strehimit social. Shërbimet ofrohen në qendër dhe në terren duke mundësuar ndjekjen nga afër të përfituesve si dhe duke siguruar koordinimin e shërbimeve në qendër me ato në banesë, në institucionet e tjera publike dhe/ose jo publike. Koha mesatare e përfshirjes në shërbim të një përfituesi është 6 muaj.

Profesionistët që ofrojnë shërbimin

Shërbimi ofrohet nga 1 punonjës social, 2 mësues dhe 1 psikolog, nën supervizionin e koordinatorës së qendrës.

Historiku i zhvillimit të shërbimit

Qendra Komunitare Multifunkionale “Për Familjen” u ngrit në vitin 2018 nëpërmjet një partneriteti të Bashkisë Shkodër me UNDP në zbatim të projektit “Fuqizimi Ekonomik dhe Social për Romët dhe Egjiptianët – shtysë për përfshirjen sociale” (FESRE), financuar nga Bashkimi Evropian. Qendra ka si përfitues kryesorë komunitetin rom dhe egjiptian dhe është pjesë funksionale shumë e rëndësishme e rrjetit të shërbimit social në komunitet, i përbërë nga 12 Qendra Komunitare “Për Familjen”. Rrjeti është ngritur nga bashkia Shkodër për ofrimin e shërbimeve sociale, sidomos ato me bazë komunitare, për familjet dhe individët në nevojë në territorin e saj.

Inovacioni

Nëpërmjet QKM “Për Familjen”, për herë të parë në Bashkinë e Shkodrës ofrohen shërbime të integruara në komunitet, të qëndrueshme dhe shumëfunktionale që kanë në fokus fuqizimin social-ekonomik të familjes. Një tjetër risi lidhet me modelin e qendrave komunitare “Për familjen”, nëpërmjet të cilit u bë e mundur krijimi i një rrjeti strukturash komunitare publike që mbulojnë një territor të caktuar dhe ofrojnë shërbime për të gjithë anëtarët e familjes.

Avantazhet

Përparësia e kësaj praktike qëndron në mundësinë që i lejon qendrës për të shtuar gamën e shërbimeve dhe për të ofruar shërbime të reja të cilat udhëhiqen nga parimi i gjithëpërfshirjes, pjesëmarrjes, krijimit të mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit pavarësisht aftësive ndryshe, gjinisë, origjinës, përkatësisë etnike, etj.

Rezultatet

Në harkun kohor prej 18 muajsh që nga hapja e saj, QKM “Për Familjen” numëron 1,540 përfitues. Ndër rezultatet e rëndësishme të qendrës mund të përmenden: regjistrimi i 182 fëmijëve nga komuniteti rom dhe egjiptian në çerdhe/kopsht/shkollë si dhe mbështetja për ndjekjen e procesit mësimor; 628 raste shërbimesh shëndetësore për familjet rome dhe egjiptiane (vizita mjekësore, vaksinim, pajisje me karta shëndeti dhe kartela vaksinimi, rimbursim medikamentesh); 72 raste të referuara për punësim, kurse të formimit profesional si dhe mbështetje për hapjen e bizneseve të vogla; asistencë në 205 raste për nevoja administrative (pajisje me karta identiteti, çertifikata familjare/personale, lidhje të martesës, regjistrim civil dhe transferim të gjendjes civile të familjeve rome nga qyteti i origjinës në qytetin e Shkodrës).

Qëndrueshmëria

QKM “Për familjen” administrohet plotësisht nga bashkia, e cila me burimet e saj mundëson financimin e shërbimeve, të cilat po shtohen edhe si rezultat i bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, duke iu përgjigjur më mirë nevojave të përfituesve. Po ashtu, godina është pronë e Bashkisë Shkodër, e cila financon edhe shpenzimet operative, të mirëmbajtjes e të personelit bazë, duke siguruar qëndrueshmërinë financiare të shërbimit. Zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të punonjësve për ngritjen, koordinimin dhe zbatimin e shërbimeve sociale specifike është një tjetër element që siguron qëndrueshmërinë e shërbimit.

Bashkëpunimi me aktorë të tjerë

QKM “Për Familjen” është ngritur si rezultat i një partneriteti të vendosur nga Bashkia me UNDP dhe partnerët e tjerë në zbatim. Për të mundësuar ofrimin e një pakete sa më të plotë shërbimesh të nevojshme për fuqizimin e komunitetit rom dhe egjiptian, por edhe të anëtarëve të izoluar e të varfër të komuniteteve të tjera, qendra bashkëpunon me disa OJF, si: Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS, Plan&GO dhe Shpresë për Botën.

Mundësia për përsëritje

Modeli i QKM “Për Familjen” është i vlefshëm, funksional dhe i mundshëm për t’u zbatuar edhe në bashki të tjera. Me miratimin e standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare multifunkionale dhe në zbatim të detyrave funksionale që ka çdo bashki për të ngritur shërbime shoqërore sa më afër komunitetit, ky shërbim është një model shumë i mirë për t’u zbatuar edhe nga bashki të tjera.

KATALOGU I PRAKTIKAVE MË TË MIRA NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR



Emri i Shërbimit

SHËRBIME SHOQËRORE PËR GJITHË CIKLIN E JETËS SË PERSONIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Ofruesi i Shërbimit

Shoqata "Ndihamoni Jetën"

Informacioni Kontakti

Adresa: Fshati Prush, Njësia Administrative Vaqarr, Tiranë

Telefon: +355(0)682084945

Email: info@helplife.org.al

Webpage: www.helplife.org

Përshkrimi i Shërbimit

Linja e shërbimeve rehabilituese bashkëshoqëruese përgjatë gjithë ciklit jetësor ofron mbështetje dhe rehabilitim me programe të specializuara dhe të diferencuara bazuar në prioritetet e moshës biologjike të personit me aftësi të kufizuara (fizike dhe intelektuale). Shërbimi mundëson zhvillimin e kapaciteteve që në fazat e para të jetës së fëmijës, edukimin e tij, gjithëpërfshirjen, deri në inkurajimin e personit me aftësi të kufizuara për të qënë i gatshëm të zhvillojë një jetë të pavarur dhe dinjitoze. Shërbimi është i hapur për përfituesit 24 orë në çdo ditë të javës. Shërbimet përfshijnë: (1) Identifikim dhe ndërhyrje e hershme për fëmijët e moshës 0-6 vjeç, model që angazhon dhe nxit bashkëpunimin e një sistemi të koordinuar të të gjithë aktorëve që kontribuojnë në zhvillimin e kapaciteteve, edukimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve 0-6 vjeç, (2) Shërbime rehabilituese dhe edukim gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara të moshës 2-21 vjeç, i cili ofron mundësinë e ngritjes së kapaciteteve, autonominë dhe gjithëpërfshirjen e fëmijës me aftësi të kufizuara, (3) Jetesa e Pavarur me

mbështetje për të rinjtë me aftësi të kufizuara mbi 24 vjeç, i cili parashikon shërbime mbështetëse dhe trajnimin e personit me aftësi të kufizuara për të jetuar i pavarur në apartamente të përshtatura, në grupe të vogla dhe në familje, aty ku individi jeton.

Profesionistët që ofrojnë shërbimin

Programet rehabilituese zbatohen nga një ekip multidisiplinar nën supervizionin e Drejtuesit Teknik, i përbërë nga: 1 psikiatër zhvillimi, 4 psikologë klinikë, 2 punonjës socialë, 2 terapistë të foluri/logopedë, 1 fizioterapist, 2 mësues të specializuar, 1 edukator social, 1 terapist arti.

Historiku i zhvillimit të shërbimit

Programet e shoqatës për edukimin dhe rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara kanë nisur në vitin 1998, me hapjen e Qendrës për Zhvillim dhe Integrim për fëmijët me aftësi të kufizuara, bazuar në filozofinë që shërbimet duhet të ofrohen që në muajt e parë të jetës së një fëmije që identifikohet se ka aftësi të kufizuara dhe të ndjekin personin në gjithë ciklin e jetës së tij. Në vazhdim, paketa e shërbimeve u pasurua me ofrimin e mbështetjes së fëmijës dhe familjes me programe të cilat janë zhvilluar të bazuara në parimet e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Inovacioni

Linja e shërbimeve rehabilituese bashkëshoqëruese përgjatë gjithë ciklit jetësor, është një ndër modelet e para dhe të vetme në vend, i hartuar që të inkurajojë bashkëpunimin ndërsektorial të strukturuar mes strukturave shtetërore në nivel vendor dhe organizatave të shoqërisë civile, për të ofruar shërbime mbështetëse për personin me aftësi të kufizuara dhe familjen e tij, bazuar në nevojat e personit përgjatë gjithë jetës.

Avantazhet

Shërbimi ofrohet nga specialistë me kompetenca të larta profesionale në fushën që zotërojnë; infrastruktura (kushtet

fizike dhe logjistika) i përmbahet standarteve të ofrimit të shërbimit, duke garantuar ambiente të aksesueshme, komode dhe inkurajuese për përfituesit; shërbimi i përshtatet kushteve, nevojave dhe mundësi në të cilat gjendet përfituesi. Modeli ka në qendër personin me aftësi të kufizuara dhe ofrohet sa më afër komunitetit ku ai jeton.

Rezultatet

Që prej fillimit të shërbimit, një numër prej 420 persona me aftësi të kufizuara kanë përfituar prej tij, nga të cilët 120 fëmijë të grup-moshës 0-6 vjeç, 215 fëmijë të grup-moshës 6-21 vjeç dhe rreth 85 të rinj të grup-moshës 21-35 vjeç. Me shtrirjen e shërbimit edhe në bashki të tjera (Durrës dhe Vlorë), nga ky model shërbimi kanë përfituar edhe 360 persona me aftësi të kufizuara të moshës 6-21 vjeç. Në mbyllje të linjës së shërbimeve, personi me aftësi të kufizuara gëzon maksimumin e potencialit të tij, funksionon mbi bazën e këtij potenciali, është integruar në jetën sociale dhe është gati për të jetuar i pavarur apo edhe me pak mbështetje, duke shmangur kështu institucionalizimin apo izolimin social në familje.

Qëndrueshmëria

Shërbimet mbështeten kryesisht me fonde nga donatorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, si dhe nëpërmjet pagesës nga përfituesit. Shoqata advokon me strukturat shtetërore në nivel vendor dhe qendror për zbatimin e legjislacionit për të siguruar mbështetjen financiare të shërbimeve si pjesë e fondit social dhe shportës së shërbimeve shoqërore. Falë një bashkëpunimi shumë të mirë me bashkitë, shoqata ndihmon për të ngritur modelin dhe për të aftësuar ofrues të tjerë të shërbimit që të sigurohet qëndrueshmëria e tij.

Bashkëpunimi me aktorë të tjerë

Për realizimin e këtij modeli është bashkëpunuar ngushtësisht me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Bashkinë, Shërbimin Social Shtetësor, organizata ndërkombëtare, institucione dhe biznese që kanë mbështetur financiarisht pjesë të programeve të këtij modeli. Në bazë të nevojave të përfituesve bashkëpunohet dhe me organizata lokale dhe Qendra të Shërbimeve Sociale.

Mundësia për përsëritje

Përveçse në Tiranë, zbatimi i modelit të shërbimeve shoqërore për gjithë ciklin e jetës së personit me aftësi të kufizuara është shtrirë edhe në Bashkitë Durrës, Vlorë dhe Kukës. Shoqata "Ndihmoni Jetën" ka përgatitur manualin e trajnimit me 12 module dhe ofron asistencë teknike për të gjithë ofruesit e tjerë të shërbimit që dëshirojnë të aplikojnë këtë model. Shoqata po advokon me strukturat shtetërore në nivel qendror dhe vendor që ta bëjnë modelin pjesë të politikave dhe planeve sociale të veprimit për të garantuar përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara përmes shërbimeve të aksesueshme, gjithëpërfshirëse dhe të specializuara në të gjithë vendin.

KATALOGU

I PRAKTIKAVE MË TË MIRA

NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE

TË KUJDESIT SHOQËROR



Emri i Shërbimit

SHËRBIMI I STREHIMIT EMERGJENT TË SIGURT

Ofruesi i Shërbimit

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

Informacion Kontakti

Adresa: Rr. e Kavajës, Pallati A, Shkalla 3, Hyrja 27, Tiranë

Telefon: +355 (0) 698233113

Email: initiative.arsis@gmail.com

Webpage: www.nisma-arsis.org

Përshkrimi i Shërbimit

Shërbimi i Strehimit Emergjent të Sigurt (SHSES), i ofruar në qendrën multifunksionale “Shtëpia e Ngjyrave”, është shërbim komunitar që siguron mbrojtje të përkohshme për fëmijët në rrezik të lartë dhe të menjëhershëm (situatë rruge, viktima të dhunës në familje, trafikimit, shfrytëzimit, pa kujdes prindëror, të pashoqëruar, etj). Shërbimi ofron mbështetje për funksionimin e mekanizmit të mbrojtjes së fëmijëve. Shërbimi fillon me ndihmën e menjëhershme për fëmijët e identifikuar në rrezik të lartë apo të menjëhershëm duke ofruar mbrojtje, siguri dhe shërbime që garantojnë interesin më të lartë të fëmijëve përgjatë kohës që strukturat e shërbimeve shoqërore ndjekin të gjitha procedurat për zgjidhjen e rastit. Vendosja e fëmijës në shërbimin e emergjencës shoqërohet me një paketë të plotë ndërhyrjesh të koordinuara me Punonjësin e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Strukturën e Shërbimeve Shoqërore në nivel bashkie. Përgjatë viteve, SHSES është zhvilluar nga një shërbim strehimor i thjeshtë në një shërbim mbështetës për fëmijët dhe nënat e tyre në rrezik të menjëhershëm, si pjesë e

rëndësishme e mekanizmit të mbrojtjes së fëmijëve. Fëmijët/nënat me fëmijë mbështeten gjatë qëndrimit në qendër me ushqim, higjenë, këshillim psikologjik, kujdes shëndetësor, aktivitete sportive dhe kreative, etj. Ata akomodohen për një periudhë që zgjat nga 72 orë deri në 11 ditë (derisa të mund të sigurohet një zgjidhje që garanton interesin më të lartë të fëmijës) sipas parashikimit të ligjit për të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Profesionistët që ofrojnë shërbimin

Shërbimi ofrohet nga një staf multidisiplinar i përbërë nga: 10 psikologë, 5 punonjës socialë; 1 infermier; 5 menaxherë rastesh; 4 mësues dhe animatorë socialë dhe personel mbështetës (4 shoferë/logjistë dhe sanitarë).

Historiku i zhvillimit të shërbimit

Shërbimi ka nisur në vitin 2010 si një projekt pilot i organizatës Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS me mbështetjen e UNICEF dhe Bashkisë Tiranë për të ofruar mbrojtje të menjëhershme për çdo fëmijë në rrezik të lartë. Në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror shërbimi është zgjeruar në nivel kombëtar për të përfshirë çdo rast të referuar nga e gjithë Shqipëria.

Inovacioni

Shërbimi i strehimit emergjent të sigurt ka nisur si një shërbim i ri në vitin 2010, i pari dhe i vetmi në nivel kombëtar. Shërbimi u vendos në funksion të plotë të nevojave të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, i cili në atë kohë ishte ende në fazat e para të zhvillimit.

Avantazhet

Shërbimi pasqyron praktikat më të mira në këtë fushë dhe parimet ndërkombëtare të barazisë, respektimit dhe garantimit të vlerave dhe personalitetit të fëmijëve, të së drejtës për të përfituar dhe për t'u mbrojtur, të mbrojtjes

së informacionit për jetën vetjake, të dinjitetit e sigurisë dhe të integritetit social. Ai është pranë komunitetit dhe familjeve vulnerabël dhe në marrëdhënie direkte me strukturat përgjegjëse të shërbimeve shoqërore, strukturat e policisë dhe gjykatës.

Rezultatet

Që prej fillimit, shërbimi numëron më tepër se 1,000 fëmijë të asistuar me shërbimin mbrojtës në të gjithë Shqipërinë, me një numër mesatar prej 100-120 përfitues në vit. Vetëm për vitin 2019, pas daljes nga shërbimi i emergjencës 26 fëmijë të shoqëruar nga prindërit e tyre (10 familje) janë rikthyer në familjet e tyre, prej të cilave 5 janë vendosur në banesa me qera, 4 familje janë vendosur pranë Qendrës Kombëtare të Emergjencave dhe 1 familje pranë Qendrës Kombëtare të Trajtitit të Viktimave të Dhunës në Familje. 24 fëmijë të pashoqëruar janë referuar dhe transferuar pranë shërbimeve të përkujdesit rezidencial, shtëpi fëmijë (publike dhe jo-publike), ndërsa 18 fëmijë të pashoqëruar janë rikthyer në familjet biologjike ose familjen e gjërë.

Qëndrueshmëria

Shërbimi mbështetet me fonde të donatorëve të huaj si UNICEF, Bashkimi Evropian, etj. Që prej fillimit, shërbimi ofrohet në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, e cila siguron ambientet dhe hapësirat e ofrimit të shërbimeve dhe prej vitit 2015 ka buxhetuar një fond të dedikuar për veprimet operacionale. Praktikrat pozitive të identifikuara gjatë fazës së pilotimit janë zhvilluar vit pas viti duke e konsoliduar shërbimin dhe rritur mbështetjen e institucioneve publike dhe njëkohësisht qëndrueshmërinë e tij.

Bashkëpunimi me aktorë të tjerë

Shërbimi ofrohet në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e shërbimeve shoqërore në bashki, ku Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve nëpërmjet planit të mbrojtjes të hartuar nga grupi teknik ndërsektorial përcakton masat e mbrojtjes si edhe nevojën për këtë lloj shërbimi për çdo fëmijë që ndodhet në rrezik të lartë apo të menjëhershëm. SHSES bashkëpunon me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimin Social Shtetëror, Drejtorinë e Policisë së Shtetit, Zyrrën e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik, Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare, etj.

Mundësia për përsëritje

Shërbimi u zhvillua mbi bazën e partneritetit jo-publik me atë publik si një model pilot, praktika pozitive e të cilit është ndarë me bashkitë Durrës, Shkodër, Dibër dhe me komunën e Prishtinës me qëllim përsëritjen e tij. Shërbimi i strehimit emergjent të sigurt ka shërbyer për të modeluar edhe shërbimet e emergjencës pranë çdo institucioni rezidencial, si dhe për hartimin e standarteve të para të shërbimit të emergjencës në Shqipëri.

KATALOGU I PRAKTIKAVE MË TË MIRA NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR



Emri i Shërbimit

PROGRAMI I AUTONOMISË PERSONALE DHE SOCIALE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Ofruesi i Shërbimit

Down Syndrome Albania

Informacioni Kontakti

Adresa: Rruga Hajredin Kumburo, Sauk, Tiranë

Telefon: +355 (0) 68 804 2222

Cel: +355 (0) 692325874

Email: f.shehu@dsalbania.org

Webpage: www.dsalbania.org

Pëshkrimi i shërbimit

Programi i autonomisë synon rritjen e autonomisë personale dhe sociale të fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara. Pjesë e programit janë individët me aftësi të kufizuara intelektuale dhe vështirësi në zhvillim. Shërbimi i autonomisë ka lider vetë personin me aftësi të kufizuara i cili merr përgjegjësi dhe vendos për aktivitetet e tij. Në këtë mënyrë ai ndihet i motivuar për të qenë i pavarur, të marrë iniciativë dhe të identifikojë nevojën për mbështetje nga jashtë, si dhe kohën e duhur kur duhet ta kërkojë këtë mbështetje. Programi përbëhet nga dy shërbime: Shërbimi i autonomisë personale për fëmijët 3-13 vjeç që është i bazuar në qendrën e shërbimeve PRO PAK dhe përfshin vetëushqyerjen, trajnimin për në tualet, proceset e veshje - zhveshjes, kujdesin ndaj vetes, kujdesin ndaj mjediseve të përbashkëta, etj. Shërbimi hartohet mbi bazën e një

vlerësimi të fëmijës dhe në ngritjen e objektivave specifike për t'u arritur në një hark kohor të paracaktuar. Procesi asistohet nga terapistë dhe prindi merr pjesë aktivisht në proces me qëllim vijimin e shërbimit në mjedisin e shtëpisë. Shërbimi i autonomisë sociale për të rinjtë 13-28 vjeç, i cili është i bazuar në komunitet dhe synon të mbështesë personat me aftësi të kufizuara që nga fëmijëria e hershme e deri në moshë të rritur për fitimin e elementëve të jetesës së pavarur. Shërbimi mundëson që adoleshentët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara të fitojnë aftësi të reja që lidhen me njohjen e rregullave të qarkullimit rrugor, përdorimin e transportit publik, njohjen e parave dhe kryerjen e blerjeve personale, organizimin e kohës së lirë për aktivitete artistike dhe kulturore, etj. Koha mesatare e përfshirjes në shërbim të një përfituesi është tre (3) vjet.

Profesionistët që ofrojnë shërbimin

Për shërbimin e autonomisë sociale janë të angazhuar: 1 koordinator terreni me profesion psikolog / punonjës social; 4 operatorë terreni me profesion logoped, psikolog ose punonjës social dhe 14 vullnetarë me profesion logoped, psikolog, punonjës social. Për shërbimin e autonomisë personale janë të angazhuar 2 operatorë me profesion logoped.

Historiku i zhvillimit të shërbimit

Shërbimi ka nisur për herë të parë në Shqipëri në vitin 2018 me një grup prej 15 të rinjsh me sindromën Down dhe me mbështetjen profesionale të 20 operatorëve dhe vullnetarëve. Iniciativa gjeti mbështetjen e profesionistëve të huaj, të cilët mundësuan modelin e shërbimit, instrumentat e duhura si dhe trajnimin intensiv të stafit. Pas suksesit dhe arritjeve në vitin e parë të programit, u vijua mbështetja për të mundësuar vazhdimësinë për të gjithë të rinjtë me aftësi të kufizuara intelektuale.

Inovacioni

Shërbimet e ofruara në funksion të programit të autonomisë

janë zbatuar për herë të parë në Shqipëri nga Fondacioni Down Syndrome Albania, duke sjellë një model tërësisht të ri. Shërbimet kombinojnë praktikat në qendër dhe ato në komunitet me qëllim aftësimin praktik të përfituesve.

Avantazhet

Shërbimi ofrohet në komunitet dhe në mjedise sa më natyrore, duke u dhënë mundësinë personave me aftësi të kufizuara të mësojnë duke provuar dhe njëkohësisht duke qenë vetë ata vendimmarrës për aktivitetet ku dëshirojnë të marrin pjesë. Programi e bën individin me aftësi të kufizuara lider të aktiviteteve, duke i rritur ndjenjën e përgjegjësisë dhe aftësitë vendimmarrëse.

Rezultatet

Cdo vit janë rreth 40 persona me aftësi të kufizuara që përfitojnë nga shërbimet e programit të autonomisë që ofron Qendra e Shërbimeve PRO PAK. Që prej muajit qershor 2019, nga shërbimi i autonomisë personale për fëmijët 3-13 vjeç kanë përfituar 15 djem dhe 10 vajza dhe nga shërbimi i autonomisë sociale për të rinjtë 13-28 vjeç, kanë përfituar 13 djem dhe 10 vajza. Nëpërmjet pjesëmarrjes në këto shërbime çdo person arrin potencialin e tij maksimal për të jetuar i pavarur në përputhje me moshën.

Qëndrueshmëria

Që prej fillimit të tij e deri më tani, ofrimi i shërbimit është siguruar nëpërmjet mbështetjes me grante nga donatorë të ndryshëm. Përfshirja e 25 vullnetarëve të cilët i kushtojnë kohën e tyre shërbimit është një aset i çmuar që ka mundësuar vazhdimësinë e tij. Nëpërmjet programit të autonomisë zhvillohen disa aftësi të jetesës së pavarur të cilat zhvillohen të shtrira në kohë dhe me bazë në komunitet, duke siguruar mirëmbajtjen dhe qëndrueshmërinë në jetesën e përditshme.

Bashkëpunimi me aktorë të tjerë

Fondacioni Down Syndrome Albania nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet vendore ka zbatuar shërbimin në nivel vendor përmes skemës së financimit të pjesshëm nga Bashkia Tiranë, nëpërmjet programit RELOAD të UNDP.

Mundësia për përsëritje

Modeli i shërbimit është lehtësisht i zbatueshëm në bashki të tjera me të gjithë elementët e tij për shkak të strukturës së konsoliduar të shërbimit, vizionit dhe planit strategjik, si dhe metodës së ndërhyrjes. Ekspertët e autonomisë kanë sjellë në gjuhën shqipe edhe një manual për operatorët që punojnë në këtë fushë.

KATALOGU

I PRAKTIKAVE MË TË MIRA

NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE

TË KUJDESIT SHOQËROR



Emri i Shërbimit

QENDRA DITORE “JETË NË ZHVILLIM” ARRAMERAS

Ofruesi i Shërbimit

Caritas Shqiptar

Informacion Kontakti

Adresa: Arrameras, Fushë-Krujë

Telefon: +355 (0) 682047928

Email: qendra.arrameras@caritasalbania.org

Facebook: Jetë në Zhvillim - Arrameras

Përshkrimi i shërbimit

Qendra Ditore “Jetë në Zhvillim” ofron shërbime zhvilluese dhe rehabilituese për personat me aftësi të kufizuara të të gjitha kategorive dhe familjet e tyre në zonën e Fushë Krujës, një nga zonat me numër më të madh të personave me aftësi të kufizuara në rang kombëtar. Qëllimi kryesor i punës në qendër është zhvillimi dhe aftësimi i personave me aftësi të kufizuara, rritja e pavarësisë së tyre dhe punësimi, çka i ndihmon të kenë dinjitet dhe personalitet në komunitetin ku jetojnë. Përfituesit marrin shërbime në këtë qendër 5 ditë të javës nga e hëna në të premte nga ora 09:00 – 14:00 duke u zhvilluar dhe aftësuar përmes terapive dhe aktiviteteve të ndryshme të aftësimit për jetën si: terapia e dekupazhit, terapia e muzikës, terapia e kopshtarisë, terapia e kuzhinës, rrobaqepësi, pikturë, etj. Përveç këtyre, përfituesit trajtohen çdo ditë në aspektin psiko-social nëpërmjet terapive individuale dhe në grup

nga ekspertë të fushës. Qendra ofron informim dhe këshillim për familjet e përfituesve të shërbimeve të saj, si dhe shërbime në familje. Meqënëse pjesa më e madhe e përfituesve vijnë nga familje me probleme të mëdha ekonomike, qendra mundëson transportin nga banesa në qendër dhe anasjelltas. Qendra gjithashtu punon dhe kontribuon në promovimin e vlerave të personave me aftësi të kufizuara duke i bërë të ndihen me integritet dhe të përfaqësuar në mënyrë të barabartë me pjesën tjetër të shoqërisë. Cdo përfitues mund të frekuentojë qendrën për një kohë të pacaktuar sipas nevojave për marrjen e shërbimit që vlerësohet nga stafi i qendrës.

Profesionistët

Shërbimi ofrohet nga një ekip multidisiplinar i përbërë nga 3 punonjës socialë, 1 infermiere, 1 terapiste e kopshtarisë, 1 terapiste e kuzhinës, 1 punonjëse e muziko-terapisë.

Historiku i zhvillimit të shërbimit

Qendra Ditore “Jetë në Zhvillim”, pjesë e Caritas Shqiptar, ka filluar aktivitetin e saj në vitin 2010. Mbas rikonstruksionit të ambienteve dhe përshtatjes sipas standarteve, qendra hapi aktivitetin e saj për 35 përfitues nga Fushë Kruja dhe zonat përreth saj. Shërbimi ka ndjekur modelin austriak të ofrimit dhe përkujdesjes për personat me aftësi të kufizuara duke i angazhuar ata në përvetësimin e një profesioni dhe aftësimit përmes tij për jetesën e pavarur.

Inovacioni

Punësimi i personave me aftësi të kufizuara është objektivi madhor i këtij shërbimi, i cili realizohet nëpërmjet zhvillimit të aftësive praktike për të kryer procese të ndryshme pune, si: përgatitja e qirinjve, punimet e drurit, rrobaqepësi, kopshtari, etj. Më pas, ata kalojnë në praktikën e punës, e cila ofrohet nga biznese dhe kompani të ndryshme në zonën përreth, për të kaluar më tej në punësimin e tyre.

Avantazhet

Shërbimi ofrohet në mjediset e brendshme dhe të jashtme të qendrës, të cilat janë përshtatur sipas standarteve dhe nevojave të përfituesve dhe kanë një sipërfaqe të madhe me ambiente pune, sportive, park shlodhës, etj. Qendra ka arritur të ndërtojë bashkëpunim shumë të mirë me bizneset lokale që ofrojnë mundësi praktike pune e më pas punësim për përfituesit e saj.

Rezultatet

Rreth 45 persona me aftësi të kufizuara nga zona e Fushë Krujës dhe fshatrave përreth dhe familjet e tyre përfitojnë nga shërbimet e qendrës ditore. 20 persona me aftësi të kufizuara që marrin shërbime në qendër kanë kryer praktikën e punës në biznese gjatë këtyre viteve dhe tre (3) përfitues janë punësuar në dy biznese. Qendra ka një ekip sportiv shumë aktiv dhe të suksesshëm, i cili është kampion kombëtar në fuqi i disiplinave futboll dhe basketboll në Lojrat Olimpike Speciale Kombëtare.

Qëndrueshmëria

Prej 10 vjetësh që nga krijimi i tij, shërbimi mbështetet me fonde nga Caritas St. Polten Austria. Duke vlerësuar nevojën në komunitet për këtë shërbim, vazhdimësia e qëndrueshmërisë në të ardhmen do të kërkonte një prezencë dhe mbështetje financiare e materiale edhe nga institucionet publike, vendore dhe qëndrore.

Bashkëpunimi me aktorë të tjerë

Qendra është pjesë e rrjetit të shoqatave dhe qendrave të profilizuara në shërbimet për personat me aftësi të kufizuara, ka bashkëpunim të ngushtë me 2 gjimnazet e Fushë Krujës me të cilat organizon në mënyrë periodike aktivitete, dhe bashkëpunon ngushtë me Bashkinë Krujë për plotësimin e nevojave që përfituesit kanë me zyrën sociale vendore apo dhe më gjerë.

Mundësia për përsëritje

Shërbimi është një model me standarte evropiane që synon mbi të gjitha integrimin e personave me aftësi të kufizuara përmes jetesës së pavarur dhe punësimit, lehtësisht të zbatueshme nga çdo ofrues shërbimesh nëse krijohet një bashkëpunim i mirë me biznesin lokal.

KATALOGU I PRAKTIKAVE MË TË MIRA NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR



Emri i Shërbimit

ALTERNATIVA TË PËRKUJDESIT MBASDITE PËR FËMIJËT E NËNAVE VIKTIMA TRAFIKIMI DHE VIKTIMA TË DHUNËS NË FAMILJE “SHTËPIA E GJYSHES / SHTËPIA TJETËR”

Ofruesi i Shërbimit

Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”

Informacion Kontakti

Adresa: Rr. “Fortuzi”, Godina 24, H. 4, Ap. 4, Tiranë

Telefon: 00355 (0) 4 2221892

Email: different&equal@icc-al.org

Website: www.differentandequal.org

Përshkrimi i Shërbimit

Alternativa të përkujdesit mbasdite për fëmijët e nënave viktime trafikimi dhe viktime të dhunës në familje “Shtëpia e Gjyshes / Shtëpia Tjetër” është një shërbim komunitar që ofrohet në Bashkitë Tiranë (dy shtëpi), Kamëz, Elbasan dhe Shkodër. Alternativat funksionojnë si qendra ditore që ofrojnë përkujdesje për fëmijët e nënave viktime të trafikimit dhe dhunës në familje përtej orarit zyrtar të funksionimit të çerdheve, kopshteve dhe shkollave publike nga e hëna në të shtunë. Gjatë periudhës së qëndrimit në “Shtëpinë e Gjyshes” për fëmijët ofrohet përkujdesje e specializuar, ushqim, aktivitete të personalizuara edukative dhe argëtuese në përputhje me moshën, zhvillimin e tyre dhe nevojat e identifikuara social-edukative, psikologjike dhe mjekësore. Për fëmijët që janë në moshë shkollare ofrohet mbështetje nga një staf i specializuar mësuesish për

përgatitjen e detyrave të shtëpisë, çka i ndihmon fëmijët të përmirësojnë rezultatet e tyre dhe të rrisin aftësitë për të punuar detyrat në mënyrë të pavarur. Si shërbim komunitar, “Shtëpitë e Gjyshes” janë vendosur në zona të përzgjedhura me kujdes për të qënë sa më pranë familjeve të fëmijëve, në mënyrë që të jenë lehtësisht të aksesueshme prej tyre. Në rastet kur është e nevojshme, për të ngushtuar distancën midis “Shtëpisë së Gjyshes” dhe familjeve të fëmijëve, shërbimi siguron dhe transport të sigurt për fëmijët nga kopshti / çerdhja në shtëpitë e gjyshes dhe kthim. Fëmijët që frekuentojnë “Shtëpitë e Gjyshes” i përkasin grupmohave nga 6 muaj deri në 9 vjeç. Koha mesatare e përfshirjes në shërbim të një fëmije është 40 orë në javë. Nuk ka një limit kohor për përfitimin e shërbimit, ai ofrohet për gjithë periudhën që vlerësohet e nevojshme për fëmijën dhe për nënën.

Profesionistët që ofrojnë shërbimin

Stafi i “Shtëpive të gjyshes” përbëhet nga 16 profesionistë, prej të cilëve 10 janë mësuese (5 mësuese kryesore/1 për secilën shtëpi dhe 5 mësuese ndihmëse/1 për secilën shtëpi); 5 punonjës socialë /1 për secilën shtëpi në rolin e administratorit/menaxherit; 1 psikolog dhe 1 mjek me kohë të pjesshme dhe shofer kur ka nevojë për transport të fëmijëve.

Historiku i zhvillimit të shërbimit

Dy alternativat e para të përkujdesit mbasdite për fëmijët janë hapur nga organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” në Bashkinë Tiranë, në maj 2017. Ideja për hapjen e tyre lindi nga nevoja për të adresuar vështirësinë në mbajtjen e një vendi pune nga përfitueset e organizatës, viktime trafikimi dhe të dhunës në familje, të cilat ishin edhe nëna. Duke qënë nëna të vetme dhe pa një rrjet mbështetës, procesi i riintegritimit për ato bëhej tejet sfidues, duke i ekspozuar jo rrallë herë fëmijët e tyre drejt neglizhimit dhe abuzimit. Alternativat u ngritën për të adresuar pikërisht këtë aspekt dhe për t’ju dhënë mundësi nënave të punonin, ndërkohë që për fëmijët e tyre ofrohej përkujdesje në një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm.

Inovacioni

Ky shërbim është i pari dhe i vetmi në llojin e tij në vend që ka ngritur modelin e përkujdesjes mbasdite pa pagesë për fëmijët e nënave të një grupi vulnerabël, siç janë viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje.

Avantazhet

Shërbimi është lehtësisht i aksesueshëm nga përfituesit e tij, ofrohet në mënyrë cilësore dhe duke pasur në çdo rast në fokus nevojat individuale dhe interesin më të lartë të fëmijës. Shërbimi ofrohet pa pagesë dhe kjo e bën plotësisht ndihmues për nënat e këtyre fëmijëve që janë në proces të rindërtimit të jetës së tyre.

Rezultatet

Që prej fillimit, rreth 88 fëmijë kanë përfituar nga ky shërbim përkujdesi me një numër mesatar prej 45 fëmijë në vit. Në Bashkinë Tiranë kanë frekuentuar shërbimin 38 fëmijë (12 vajza dhe 26 djem); në Bashkinë Elbasan 16 fëmijë (5 vajza dhe 11 djem); në Bashkinë Kamëz 20 fëmijë (11 vajza dhe 9 djem); në Bashkinë Shkodër 14 fëmijë (7 vajza dhe 7 djem). Fëmijët që frekuentojnë këtë shërbim shfaqin përmirësim të dukshëm dhe të qëndrueshëm të mirëqenies emocionale dhe psikologjike, në procesin e të nxënit si dhe kanë rezultate më të mira në shkollë. Janë ulur ndjeshëm rastet e fëmijëve që shfaqin probleme që lidhen me kequshqyerjen, me shëndetin fizik e mendor.

Qëndrueshmëria

Shërbimi është ngritur dhe funksionon mbi bazën e bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore, të cilat mbulojnë edhe një pjesë të kostove operative, e në disa raste dhe mjediset për funksionimin e shërbimit (Bashkitë Tiranë, Elbasan e Shkodër). Kostot e tjera mbulohen nga donatorë të ndryshëm.

Bashkëpunimi me aktorë të tjerë

Shërbimi funksionon në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë Rajonale Arsimore Tiranë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve (QEZHEF) në Bashkinë e Tiranës, me organizatat “Tjetër Vizion” në Elbasan dhe “Global Care Albania” në Kamëz, si dhe Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF) në të katër bashkitë.

Mundësia për përsëritje

Modeli i ngritur fillimisht në Tiranë është përhapur brenda dy viteve në Bashkitë Kamëz, Elbasan e Shkodër. Funksionimi i shërbimit bazohet në Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Fëmijët në Nevojë në Qendrat Ditore Publike dhe Jo-publike, dhe në një sërë dokumentesh të nevojshme për funksionimin e brendshëm të përgatitura nga organizata, të cilat mund të shërbejnë si një bazë e mirë për përsëritjen me sukses të shërbimit edhe në bashki të tjera.

KATALOGU I PRAKTIKAVE MË TË MIRA NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR



Emri i Shërbimit

QENDRA E ZHVILLIMIT LUSHNJE

Ofruesi i Shërbimit

Bashkia Lushnje

Informacion Kontakti

Adresa: Lagja "Xhevdet Nepravishta",
pranë spitalit "Ihsan Çabej"

Telefon: +355 (0) 696271784/(0) 699763888

Email: bashkia_lushnje@yahoo.com;
qendraezhvillimitlushnje@gmail.com

Webpage: www.bashkialushnje.gov.al

Facebook: Qendra e Zhvillimit Lushnje

Përshkrimi i Shërbimit

Qendra e Zhvillimit Lushnje është një qendër komunitare që ofron shërbime terapeutike, rehabilituese dhe edukative për mbajtjen dhe rritjen e aftësive sociale, fizike dhe autonominë vetjake për fëmijë me aftësi të kufizuara të grupmoshës 2 - 16 vjeç. Shërbimet e ofruara përfshijnë terapinë e zhvillimit (edukimit), të të folurit, të punës dhe atë fizike si dhe aktivitete rekreative dhe të socializimit. Shërbimi ofrohet në tre fasha orare të ndryshme. Paradite ofrohet shërbim për fëmijët që nuk frekuentojnë as shkollat as kopshtet, rreth mesditës në qendër vijnë fëmijët që frekuentojnë shkollat ose kopshtet me orar të reduktuar dhe pasdreke janë fëmijë që frekuentojnë rregullisht shkollat apo kopshtet. Periudha gjatë së cilës një fëmijë mund të vijojë të marrë shërbime në qendër bazohet në planin individual të zhvillimit sipas të cilit një fëmijë mund të marrë një ose më shumë shërbime terapeutike, në

mënyrë individuale ose në grup, me një shpeshtësi nga një deri disa herë në javë. Qarkullimi i fëmijës nga një shërbim tek tjetri dhe polivalenca e personelit specialist janë karakteristika të këtij modeli shërbimi.

Profesionistët që ofrojnë shërbimin

Shërbimi ofrohet nga një staf multidisiplinar i përbërë nga 1 përgjegjës, 1 punonjës social, 2 logopedistë, 5 psikologë, 2 fizioterapistë dhe staf mbështetës.

Historiku i zhvillimit të shërbimit

Qendra e Zhvillimit Lushnje është hapur në vitin 2016 me mbështetjen e UNDP dhe financim nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Fillimisht qendra u konceptua për t'i shërbyer vetëm fëmijëve të qytetit të Lushnjes. Pas reformës administrative territoriale, si rrjedhojë e së cilës Bashkisë Lushnje iu bashkuan edhe 10 njësi administrative (ish-komuna), qendra u ngarkua të mbulojë me shërbime të kujdesit shoqëror për fëmijët më aftësi të kufizuara të gjithë territorin e bashkisë aktuale. Qendra nisi punë me një staf prej 6 punonjësish, ndërsa sot numëron rreth 11 punonjës specialistë dhe 7 punonjës mbështetës.

Inovacioni

Qendra me shërbimet e saj ishte risi për Bashkinë Lushnje sepse, para hapjes së saj në këtë territor nuk kishin ekzistuar shërbime publike dhe jo-publike për fëmijët me aftësi të kufizuara. Shërbimet e ofruara në qendër janë të specializuara dhe multidisiplinare njëkohësisht, duke garantuar një aftësim dhe zhvillim shumëplanësh të fëmijës dhe duke e përgatitur atë për jetesë autonome në familje, shkollë dhe komunitet. Një tjetër risi e modelit është ndërhyrja në moshën e hershme dhe, si rrjedhojë, bashkëpunimi i ngushtë me çerdhet dhe kopshtet, ku punonjësit e qendrës shkojnë rregullisht për të identifikuar që në periudhën e hershme fëmijët me aftësi të kufizuara, sidomos ata të spektrit autik. Falë këtij identifikimi, fëmijët bëhen pjesë e shërbimit dhe trajtohen me terapitë e nevojshme.

Avantazhet

Me ngritjen e qendrës së zhvillimit, fëmijët me aftësi të kufizuara që jetojnë në territorin e bashkisë Lushnje marrin një shërbim cilësor, pa pagesë dhe me infrastrukturë cilësore.

Rezultatet

Gjatë periudhës katër-vjeçare të funksionimit të saj, qendra ka ofruar shërbime për rreth 210 përfitues të grupmoshës 3 - 16 vjeç (me një numër mesatar prej 65 përfituesish në vit), prej të cilëve 41% janë vajza dhe 85% nga zonat jo urbane. Bazuar në vështirësitë specifike të çdo fëmije, qendra shënon përmirësime të matshme në riaftësimin e tyre. Një ndër rezultatet kryesore të punës së qendrës është fakti që 61% e përfituesve të shërbimit që nuk frekuentonin institucionet arsimore megjithëse në moshë shkolle, kanë mundur të integrohen në shkolla të zakonshme.

Qëndrueshmëria

Prej vitit 2016 e në vazhdim veprimtaria e qendrës është mbështetur nga bashkia në kuadër të përgjegjësi që i lindën pas reformës së decentralizimit. Në vitin 2020, bashkia ka përfituar financim nga Fondi Social për të shtuar numrin e punonjësve të qendrës me tre specialistë për t'iu përgjigjur më mirë numrit në rritje të fëmijëve me aftësi të kufizuara që kërkojnë dhe kanë nevojë të marrin shërbimet që ajo ofron. Bashkëpunimi me insitucionet e arsimit parashkollor dhe parauniversitar si dhe mbështetja me profesionalizëm e prindërve kanë rritur vlerën e shërbimit duke sjellë rritjen e vetëdijes së komunitetit për ekzistencën e shërbimeve të ofruara dhe vlerën e tyre e për rrjedhojë, ndërgjegjësimin më të madh të bashkisë për mbështetje të qëndrueshme.

Bashkëpunimi me aktorë të tjerë

Qendra ka bashkëpunim të ngushtë me shkollat dhe kopshtet që veprojnë në territorin e Bashkisë Lushnje për identifikimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara që në moshë të hershme. Qendra vazhdon të mbështetet me trajnime për stafin nga UNDP.

Mundësia për përsëritje

Qendra e Zhvillimit Lushnje është nga qendrat e para publike komunitare për fëmijë me aftësi të kufizuara të ngritura në Shqipëri. Tipologjia e shërbimeve të ofruara, modaliteti i ofrimit të shërbimeve, bashkëpunimi me kopshtet, shkollat dhe prindërit, lobimi dhe përfshirja e komunitetit të biznesit dhe jo vetëm, kanë ndërtuar një model funksional, të qëndrueshëm dhe të përsëritshëm.

KATALOGU I PRAKTIKAVE MË TË MIRA NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR



Emri i Shërbimit

SHËRBIMI KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE

Ofruesi i Shërbimit

Qendra e Gruas “Hapa të Lehtë”, Shkodër

Informacioni Kontakti

Adresa: Rruga e Murgeshave, Nr. 6 (Gjuhadol)

Telefon: +355 (0) 2241316

Email: qendragruashk@yahoo.com

Webpage: www.hapatelehte.org

Facebook: Hapa te lehte

Përshkrimi i Shërbimit

Shërbimi kundër Dhunës me bazë Gjinore mbron të drejtat e grave, fëmijëve dhe të rinjve dhe punon për fuqizimin social-ekonomik dhe riintegrimin e viktimave të dhunës në familje (VDHF) në tre drejtime: 1) Shërbime individuale të specializuara e pa pagesë për viktimat e dhunës me bazë gjinore (gra dhe vajza). Shërbimi përfshin mbështetje psiko-sociale, ligjore, shoqërim në terren (për të marrë shërbime në institucionet publike dhe jo publike, për të kërkuar shtëpi më qera, etj.), punësim, strehim, kurse të formimit profesional dhe bibliotekë për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Shërbimi ofrohet edhe për fëmijët e viktimave, për të cilët ofrohet mbështetje psikologjike, qendër ditore, kurse të formimit profesional, etj. Si pjesë e qendrës funksionon edhe Bar – Restorant Arti’Zanave, i cili shërben jo vetëm për punësimin e viktimave të dhunës në familje, por edhe për socializimin e grave në përgjithësi. 2) Shërbime komunitare, që përfshijnë takime ndërfaqësuese për parandalimin e dhunës me bazë gjinore. 3) Punë me institucionet publike, për t’i bërë me përgjegjëse për detyrat e tyre. Në këtë drejtim

qendra është edhe anëtare e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) dhe Ekipit Teknik Ndërdisciplinor (ETN) në mbështetje të VDHF në nivel vendor.

Historiku i zhvillimit të shërbimit

Shërbimi kundër dhunës me bazë gjinore ka lindur në vitin 2003, me hapjen e Qendrës së parë të Gruas në Shkodër nga organizata ndërkombëtare COSPE-Itali, si pasojë e mungesës së shërbimeve sociale në territorin e Shkodrës. Me kalimin e viteve shërbimi u specializua gjithnjë e më tepër për të adresuar çështje komplekse të grave të dhunuara si: zgjidhje martesë, Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje (UMM) dhe Urdhër Mbrojtje (UM), strehim emergjent, punësim, formim profesional, etj. Në vitin 2003, ende pa u miratuar Ligji Nr.9669, datë 18.12.2006, ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’, qendra ngriti tryezën e parë ndërinstitucionale për koordinimin dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore të rasteve të dhunës në familje në Bashkinë Shkodër me përfaqësues nga bashkia, policia, prokuroria, gjykata, spitali rajonal dhe OJF të tjera.

Profesionistët që ofrojnë shërbimin

Shërbimi ofrohet nga një ekip i përbërë nga 2 punonjës socialë, 2 psikologe dhe 2 juriste.

Inovacioni

Eksperiencia e krijuar ndër vite nga shërbimet e qendrës dhe nevoja për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme bënë që në vitin 2020 Qendra e Gruas të hapte Bar Restorant Arti’Zanave, i cili shërben për punësimin dhe socializimin e grave me probleme social-ekonomike, si edhe për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve të shërbimit kundër dhunës me bazë gjinore. Në këtë bar-restorant janë punësuar tre gra me probleme social-ekonomike.

Avantazhet

Mbështetja për fuqizimin ekonomik ndaj VDHF dhe fëmijëve të tyre është një ndër avantazhet e shërbimit. Pas mbështetjes psiko-sociale në fazën emergjente i kushtohet një rëndësi e

veçantë ngritjes së kapaciteteve për krijimin e pavarësisë ekonomike, gjetjes dhe krijimit të mundësive për punësim. Bashkëpunimi i ngushtë ndër vite me institucionet vendore si pjesë e mekanizmit të referimit të dhunës në familje në bashkitë Shkoder, Vau Dejës dhe Pukë përbën një tjetër avantazh të rëndësishëm për ofrimin e qëndrueshëm të shërbimit.

Rezultatet

Në 17 vite të funksionimit të tij, nga shërbimi kundër dhunës me bazë gjinore kanë përfituar mbi 2,000 persona, me një numër prej rreth 100 përfitues në vit. Disa nga rezultatet e lidhura me gratë VDHF përfshijnë eliminimin e dhunës në familje në rastet e zgjidhjes së martesës dhe marrjes së Urdhrit të Mbrojtjes, reduktimin e dhunës në rastet kur gratë vazhdojnë të jetojnë me dhunuesit, nëpërmjet mbështetjes psikologjike në familje duke përfshirë edhe dhunuesin, si dhe rritjen e pavarësisë së tyre.

Qëndrueshmëria

Shpenzimet e shërbimit mbulojnë nga zbatimi i projekteve të financuara nga donatorë të ndryshëm. Biznesi social Bar Restorant "Arti Zanave", aktiviteti i Qendrës së Gruas mbështet me një pjesë të të ardhurave shërbimin duke garantuar qëndrueshmërinë e tij. Një element i rëndësishëm i qëndrueshmërisë është edhe puna vullnetare e profesionistëve të cilët vazhdojnë të ofrojnë shërbimet psiko-sociale edhe në periudhat e mungesës së mbështetjes financiare nga donatorët.

Bashkëpunimi me aktorë të tjerë

Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë" bashkëpunon ngushtësisht me ofrues të ndryshëm shërbimesh publikë dhe jo-publikë në nivel vendor, si: Drejtoria e Shërbimit Social, Policia, Zyra e Formimit Profesional, Zyra Rajonale e Punësimit në Bashkitë Shkodër, Pukë dhe Vau Dejës, organizata ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale, si: SOS-Fshatrat e Fëmijëve, Gruaja tek Gruaja, The Door, Qendra Rinore Pukë, Gruaja Verilindore e Papunë Pukë, Papa Xhovani XXIII, etj. Qendra bashkëpunon edhe me biznese private për punësimin e VDHF.

Mundësia për përsëritje

Pas eksperiencës në Bashkinë Shkodër, në vitin 2015 shërbimi u shtri edhe në Bashkinë Pukë, përmes krijimit të sportelit Oda e Grave, ndërsa në janar 2019, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Social të Bashkisë Vau Dejës u ngrit Qendra Sociale, ku përveç aktiviteteve të tjera socio-ekonomike ofrohet edhe shërbimi kundër dhunës me bazë gjinore. Qendra po vlerëson mundësinë e hapjes së shërbimit edhe në bashkitë e tjera të Qarkut Shkodër si: Bashkia Fushë-Arrëz dhe Bashkia Malësi e Madhe.

KATALOGU

I PRAKTIKAVE MË TË MIRA

NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE

TË KUJDESIT SHOQËROR



Emri i Shërbimit

SHTËPI MIKPRIËSE "SANTA MARIA"

Ofruesi i Shërbimit

Shoqata Komuniteti Papa Xhovani i XXIII, Shkodër

Informacioni Kontakti

Telefon: +355 (0) 692086327

Email: papaxhovani23@gmail.com

Përshkrimi i Shërbimit

Shtëpi Mikpritëse "Santa Maria" është një strehëz që ofron mbrojtje dhe rehabilitim për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare. Përfituesit kryesorë të shërbimit janë vajzat e rritura dhe nënat me fëmijë, të identifikuar si viktima të dhunës në familje. Modeli i shërbimit synon t'i afrohet sa më shumë jetesës familjare, duke ofruar një ambient të mbrojtur, të pasur nga ana afektive, që merr në konsideratë unicitetin e secilit individ duke vlerësuar prirjet dhe aftësitë e ndryshme dhe që stimulon autonominë personale. Shërbimi funksionon bazuar në modelin e bashkëndarjes direkte të jetës me personat e pranuar në shërbim, sipas të cilit ofruesit e shërbimit ndajnë jetën e tyre të përditshme me përfituesit duke qenë në gadishmëri të plotë 24 orë në shtatë ditë. Shërbimet e ofruara përfshijnë strehimin, ushqimin, shërbimin shëndetësor, mbështetjen psikosociale, referime për punësim ose formim profesional, referime për çështjet ligjore, arsimim dhe shërbime të specializuara për fëmijët, aktivitete social-kulturore dhe

çdo gjë tjetër që përfshin jeta familjare. Në këtë mënyrë, përveç trajtimit të problemeve të dhunës në familje dhe traumave që lidhen me të, shërbimi përmbush njëherësh disa nevoja si fuqizimin e individit dhe familjes, edukimin për të ardhmen, pavarësinë ekonomike dhe riintegrimin si në kontekstin familjar dhe atë komunitar. Gjithashtu, ofohet mbështetje për një fazë kalimtare afatmesme, pas daljes nga strehëza. Koha mesatare e qëndrimit në strehëz është 12 muaj.

Historiku i zhvillimit të shërbimit

Që prej 20 vitesh, shoqata Komuniteti Papa Xhovani i XXIII është përkrah vajzave dhe grave në situatë dhune, duke ofruar një marrëdhënie besimi, ndihmë dhe mbështetje psikologjike e shpirtërore. Në janar 2018 u hap zyrtarisht Strehëza, një shërbim i ri i specializuar dhe i dedikuar për viktimat e dhunës në familje, si përgjigje ndaj kërkesave të vazhdueshme për strehimin dhe akomodimin e viktimave të dhunës në familje së bashku me fëmijët e tyre.

Profesionistët që ofrojnë shërbimin

Shërbimi ofrohet nga 2 psikologe, 1 punonjës social dhe një kujdestare.

Inovacioni

Një shërbim i tillë afatgjatë për viktimat e dhunës në familje nuk ofrohet nga asnjë ofrues tjetër shërbimesh publik apo jo-publik në rajonin e veriut. Qëllimi nuk ka qenë ngritja e një institucioni rezidencial, por mikpritja në një familje të zgjeruar për të gjitha vajzat dhe gratë me fëmijët e tyre që janë në situatë të vështirë dhune, duke i bërë të ndihen të pranuar, me dinjitet, të mbrojtur, të barabartë dhe që së bashku të shohin nga e ardhmja.

Avantazhet

Jetesa në strehëz është krejtësisht e dominuar nga karakteri familjar, ku secili anëtar ka rolin e vet brenda

familjes së madhe; ku të gjithë janë të pranuar dhe asnjë i përjashtuar. Të gjithë përpiqen jo vetëm për mirëqenien personale por edhe atë kolektive familjare, duke ndihmuar njëri-tjetrin për tejkalimin e historive të dhimbshme apo traumave të përjetuara.

Rezultatet

Që prej fillimit të saj, qendra ka ofruar shërbime për 27 përfitues në total, ndër të cilët 2 vajza, 9 gra, dhe 16 fëmijë. Përfituesit kanë qenë kryesisht nga bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe, Pukë dhe Vau Dejës. Rastet e trajtuara në Shtëpinë Mikpritëse kanë qenë të suksesshme pasi të gjitha kanë rezultuar në përmirësim të situatës së përfituesve dhe asnjë nuk është kthyer në gjendjen fillestare.

Qëndrueshmëria

Financimi i shërbimit realizohet nëpërmjet shoqatës mëmë Komuniteti Papa Xhovani i XXIII me qendër në Rimini, Itali, e cila vepron prej 20 vjetësh në Shqipëri me projekte afatgjata, duke vendosur në qendër të misionit drejtësinë sociale “derisa të fundit të jenë të parët”. Vazhdueshmëria e shërbimit sigurohet edhe nga gadishmëria e misionarëve të Komunitetit Papa Xhovani i XXIII, të cilët kanë bërë zgjedhjen e bashkëndarjes së jetës së tyre me personat në nevojë.

Bashkëpunimi me aktorë të tjerë

Qendra është në bashkëpunim të vazhdueshëm me zyrën e koordinatorit lokal për rastet e dhunës në familje në Bashkinë Shkodër. Shërbimi Social i bashkisë monitoron në vazhdimësi zbatimin e Urdhrit të Mbrojtjes për përfitueset e shërbimit, ndërsa njësisia e mbrojtjes së fëmijëve ndjek ecurinë e fëmijëve të shoqëruar nga nëna me Urdhër Mbrojtje. Nëpërmjet partneritetit me organizatat e shoqërisë civile, si Shoqata Gruaje të Gruaja apo Organizata Shqiptare e Urdhrit të Maltës (Malteser) është bërë e mundur ofrimi i shërbimeve mbështetëse si arsimimi i fëmijëve, konsulencë ligjore, etj. Strehëza është pjesë e Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit Të Personave pranë Prefekturës Shkodër.

Mundësia për përsëritje

Ky shërbim përmbush disa nevoja njëherësh dhe ka në themel të tij dëshirën për t’u ardhur në ndihmë njerëzve në nevojë dhe bashkëpunimin me institucionet dhe organizatat e tjera që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare. Për këto arsye mund të aplikohet lehtësisht nga organizata të tjera që kanë në fokus shërbimet për familjen, çështjet e barazisë gjinore, fuqizimin e familjeve vulnerabël, etj.

KATALOGU

I PRAKTIKAVE MË TË MIRA

NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE

TË KUJDESIT SHOQËROR



Emri i Shërbimit

SHËRBIM KOMUNITAR

Ofruesi i Shërbimit

Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën / SHKEJ

Informacion Kontakti

Adresa: Blv Zogu 1, Pll 115, H 2, Ap 39, Tiranë

Telefon: +355 (0) 4 226 5398

Email: shkej@albmail.com

Webpage: www.shkej.org

Facebook: SHKEJ

Përshkrimi i Shërbimit

Shërbimi komunitar i ngritur nga SHKEJ ofrohet nëpërmjet Qendrës “Eden” dhe Qendrës “Engjëjt e Vegjël”. Shërbimi ka në fokus familjet vulnerabel dhe në vështirësi të thella ekonomike dhe sociale, kryesisht të komunitetit rom dhe egjiptian, fëmijë dhe të rinj në situatë rruge, fëmijë në risk të braktisjes së shkollës ose që e kanë braktisur, fëmijë jashtë sistemit të mbrojtjes sociale, të rinj në risk të përdorimit të substancave narkotike dhe sjelljeve të rrezikshme/ antisociale, vajza që përfshihen në martesë të hershme, të rinj të cilët duan të rrisin kompetencat dhe aftësitë në mënyrë që të sjellin ndryshim social dhe ekonomik në komunitet. Shërbimet e ofruara konsistojnë në: (1) Shërbime komunitare në qendër për fëmijë të moshës 3-14 vjeç, që përfshijnë aktivitete edukative si klasa për analfabetë, mbështetje shkollore, aktivitete paraprake për shkrim dhe lexim, pajisje me mjetet e nevojshme shkollore, kujdes psikologjik, shëndetësor dhe higjienik, vakte të shëndetshme ushqimore, si dhe orientim, referim dhe mbështetje për regjistrime në kopsht, çerdhe dhe shkollë; (2) Shërbime

komunitare në qendër për të rinjtë 15-21 vjeç, si: aktivitete të ndryshme sociale dhe edukative, trajnime, ndihmë me materiale didaktike shkollore, regjistrim në kurse të formimit profesional, orientim për punësim, aktiviteteve argëtuese jashtë ambienteve të qendrës, ndihmë të drejtpërdrejtë në raste të veçanta dhe aktivitete artistike sipas talenteve dhe aftësive; (3) Shërbime për familjet, si: orientim, referim, këshillim dhe shoqërim për punësim, kujdes shëndetësor, mbështetje për çështje administrative dhe ligjore, trajnime/ sesione informimi për prindërimin pozitiv, si dhe ndihmë direkte në raste emergjente.

Profesionistët

Shërbimi në dy qendrat ofrohet nga një ekip multidisiplinar dhe përbëhet nga 2 psikologë, 7 punonjës socialë, 1 edukatore, 1 ndihmës edukatore, 1 mësuese mbështetëse, 1 financiar dhe 2 kuzhinierë.

Historiku i zhvillimit të shërbimit

Shërbimi komunitar i SHKEJ nisi në vitin 2003 me hapjen e Qendrës Komunitare “Eden” në njësinë Administrative Nr. 11, e cila përgjatë viteve ka mbështetur një numër të konsiderueshëm familjesh vulnerabel në Njësitë Administrative Nr. 1, 2 dhe 11 në qytetin e Tiranës. Në vitin 2008 u hap Qendra Komunitare “Engjëjt e Vegjël” në Njësinë Administrative Nr. 9, e cila ka kryer aktivitetet e saj kryesisht në Njësitë Administrative Nr. 8 dhe 9. Shërbimi është një model i përmirësuar ndër vite, me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e familjeve vulnerabel, në mënyrë që ato të arrijnë potencialin e plotë për një jetesë më cilësore.

Inovacioni

Shërbimet që ofrohen me synim Përmirësimin e Zhvillimit në Fëmijërinë e Hershme, mosha 0-6 vjeç, janë shërbime që për herë të parë në nivel vendor ofrohen nga një Qendër Komunitare. Një tjetër risi e shërbimit është “Mobile Kitchen”, një aktivitet me fokus mësimin e gatimit dhe socializimin në komunitet, që ofrohet nga stafi i qendrave në shtëpitë e përfituesve duke gatuar së bashku.

Avantazhet

Eksperienca e gjatë prej 17 vitesh e SHKEJ në njohjen e komuniteteve vulnerabël dhe nevojave të tyre, si dhe në ofrimin e shërbimeve direkte për të adresuar këto nevoja, përbën një ndër avantazhet e shërbimit. Shumëllojshmëria e shërbimeve direkte të ofruara dhe lehtësia e marrjes së shërbimeve nga përfituesit, janë elementët që e bëjnë më efektiv këtë shërbim dhe me ndikim të menjëhershëm.

Rezultatet

Ndër vite, shërbimi ka rritur kapacitetet e rreth 1,200 fëmijë dhe të rinjve, të cilat u kanë shërbyer për të ndërtuar një perspektivë pozitive për jetën, ka fuqizuar rreth 750 gra për të rritur autonominë e tyre, për të fituar respektimin e të drejtave dhe rolit të tyre të rëndësishëm në familje, dhe ka përmirësuar aftësitë e rreth 450 familjeve për mirërritjen dhe kujdesin për fëmijët e tyre dhe për një jetesë më cilësore.

Qëndrueshmëria

Qëndrueshmëria e shërbimit sigurohet nëpërmjet projekteve të mbështetura me grante nga donatorë të ndryshëm, entet publike dhe private. Eksperienca e gjatë si ofrues shërbimesh për komunitetet ka ndikuar në krijimin e një lidhje të fortë me përfituesit, krijimin e besueshmërisë së donatorëve dhe referimit të qendrës si një urë e fortë lidhëse midis institucioneve vendore dhe komunitetit. Mbështetja ndaj liderëve të komunitetit në iniciativat që ata ndërmarrin ka ndikuar në fuqizimin e tyre për të adresuar në mënyrë të pavarur problematikat dhe nevojat e komunitetit që përfaqësojnë.

Bashkëpunimi me aktorë të tjerë

SHKEJ me anë të Qendrave Komunitare është themeluese dhe pjesë e disa rrjeteve kombëtare që shërbejnë për të forcuar lidhjen mes pushtetit vendor, shoqërisë civile dhe përfituesve, si: Rrjeti i Kombëtar i Qendrave për Fëmijë në Situatë Rruge; Rrjeti Kombëtar Bashkë për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve (BKTF); Rrjeti URAT (Përgjigja e Bashkuar kundër Trafikimit), Aleanca për Arsimin. Ato janë një mekanizëm i rëndësishëm nëpërmjet të cilave adresohen problematikat e përfituesve në instancat e duhura, advokohet e lobohet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe rritet bashkëpunimi për ofrimin e shërbimeve me efektshmëri të lartë.

Mundësia për përsëritje

Programet e shërbimeve që ofrohen në të dy qendrat komunitare janë të mbështetura në disa karakteristika lehtësisht të zbatueshme dhe nga ofrues të tjerë, si: ofrimi i shërbimeve në përshtatje me legjislacionin shqiptar, protokollet e punës me fëmijët dhe standartet e qendrave komunitare, ofrimi i shërbimeve bazuar në vlerësimin e nevojave të komuniteteve vulnerabël, si dhe ngritja e qendrave komunitare në afërsi të komunitetit që përfiton shërbimet.

KATALOGU I PRAKTIKAVE MË TË MIRA NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR



Emri i Shërbimit

QENDRA E SHËRBIMEVE ME BAZË KOMUNITARE PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Ofruesi i Shërbimit

Bashkia Durrës

Informacion Kontakti

Adresa: L.17, Rruga "Dalip Peza", Banesat sociale, Durrës

Telefon: +355(0)52201845

Email: alda.agolli@durres.gov.al

Përshkrimi i Shërbimit

Qendra e shërbimeve me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara të grupmoshës 2-21 vjeç, punon me fëmijët dhe familjet e tyre për gjithëpërfshirjen në kopshte, shkolla dhe komunitet. Qendra ofron:

I. Shërbime direkte për fëmijët me aftësi të kufizuara në fushën e sjelljes, komunikimit, autonomisë, edukimit, aftësive akademike dhe motorikës. Shërbimi ofrohet nga e hëna në të premte, me program grupi dhe program individual.

II. Aftësim të familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të punuar me fëmijën në kushte shtëpie dhe për të advokuar për gjithëpërfshirjen e tyre në arsim dhe komunitet. Gjithashtu, prindërit kanë mundësi të përfitojnë sesione këshillimi të psikologjia e qendrës.

III. Ndërgjegjësimin e komunitetit për të mbështetur gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Qendra organizon një sërë aktiviteteve ndërgjegjësuese, për të ndarë në komunitet mesazhin e gjithëpërfshirjes dhe jetesës së pavarur.

Koha mesatare e përfshirjes në shërbim të një përfituesi është 2 sesione në javë. Rastet që trajtohen në qendër marrin shërbime në përshtatje me moshën dhe zhvillimin e tyre gjatë gjithë jetës.

Historiku i zhvillimit të shërbimit

Qendra është hapur në vitin 2016, si një nevojë për të mbështetur me shërbime fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në Durrës. Për krijimin e saj, Bashkia e Durrësit bashkëpunoi me organizatën Save the Children, e cila nëpërmjet një projekti 3-vjeçar në partneritet me shoqatën "Ndihmoni Jetën" bëri të mundur restaurimin e ambjenteve ku do të ngrihej qendra, trajnimin e stafit, ofrimin e shërbimeve për fëmijët dhe familjet dhe krijimin e rrjetit të bashkëpunëtorëve. Pas përfundimit të projektit që ngrii themelet e qendrës, administrimi i saj i ka kaluar tërësisht Bashkisë Durrës, e cila ka ofruar mbështetje maksimale për të ruajtur standartet e vendosura.

Profesionistët që ofrojnë shërbimin

Shërbimet ofrohen nga një staf multidisiplinar i përbërë nga 1 punonjës social, 1 psikolog, 1 logoped, 1 fizioterapist dhe 2 terapistë zhvillimi.

Inovacioni

Qendra është e vetmja në Durrës që ofron këtë model shërbimi publik, ku e gjithë familja është përfituese shërbimesh. Krijimi i grupeve vetë-ndihmuese me motra dhe vëllezër të fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilët takohen çdo muaj me psikologun e qendrës dhe ndajnë emocionet, ndjesitë dhe përvojat e përbashkëta, është një element i ri i shërbimit.

Avantazhet

Modeli i këtij shërbimi ka si avantazh fokusin tek e gjithë familja dhe mbështetja e saj. Rëndësi e veçantë i kushtohet marrëdhënies me familjarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara, jo vetëm duke i informuar mbi problematikat e fëmijës, por

edhe duke kuptuar kompleksitetin e marrëdhënieve familjare dhe mënyrat se si ata mund të ndihmohen në bashkëpunim edhe me partnerët e tjerë lokalë.

Rezultatet

Që nga hapja e saj, në qendër kanë përfituar shërbime 116 fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara (35 femra dhe 81 meshkuj) dhe familjarët e tyre, me një numër prej 75 fëmijë përfitues në vit. Të ndarë sipas grupmoshave, 13% e përfituesve janë 2-5 vjeç, 40% janë 6-10 vjeç, 32% i përkasin grupmoshës 11-15 vjeç dhe 15% grupmoshës 16-21 vjeç. Të përfituesit vihen re përmirësime në fushën e përfshirjes sociale, sjelljes, performancës vizuale, autonomisë personale, komunikimit, motorikës fine dhe globale. Nga ana e prindërve, ka rritje të nivelit të kuptueshmërisë së fëmijëve me aftësi të kufizuara, problematikave dhe aftësive të tyre si dhe rritje të njohurive mbi mundësitë e advokimit për të drejtat e fëmijëve të tyre.

Qëndrueshmëria

Shpenzimet e qendrës janë parashikuar në buxhetin afatmesëm të Bashkisë (2019-2021) dhe do të vazhdojnë të përfshihen edhe në të ardhmen. Ndërkohë, vazhdon bashkëpunimi me Save the Children që mbulon shpenzimet për blerjen e një pjese të materialeve të punës me fëmijët, zhvillimin e disa aktiviteteve dhe rritjen e kapaciteteve të stafit e të prindërve për të siguruar qëndrueshmërinë e zhvillimit të arritur nga fëmijët, si rezultat i shërbimeve të ofruara në qendër dhe vazhdimit të tyre në familje.

Bashkëpunimi me aktorë të tjerë

Për të plotësuar të gjitha nevojat për shërbime të përfituesve të saj, qendra ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me ofrues të tjerë shërbimesh publikë dhe jo-publikë në nivel vendor, si: Drejtoria Rajonale Shëndetësore, Drejtoria Arsimore, Qendra e Formimit Profesional, Qendra e shëndetit mendor “Drejt Zhvillimit”, etj. Organizata World Vision ka qenë shpesh mbështetëse e aktiviteteve të qendrës duke plotësuar nevojat për aktivitete ndërgjegjësuëse dhe argëtuese.

Mundësia për përsëritje

Rezultatet pozitive të punës së deritanishme janë të lidhura ngushtë me modelin komunitar të shërbimeve që kjo qendër aplikon, i cili është lehtësisht i zbatueshëm edhe nga ofrues të tjerë. Shërbimi është në përputhje të plotë me politikat dhe reformën e mbrojtjes sociale për personat me aftësi të kufizuara, u përgjigjet nevojave për shërbime mbështetëse që sigurojnë aftësim dhe integrim të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe synon të sigurojë angazhim konkret të institucioneve përgjegjëse për dhënien e këtyre shërbimeve. Për këto arsye shërben si një shembull i mirë që mund të ndiqet edhe nga bashki të tjera që nuk e ofrojnë këtë shërbim.

KATALOGU

I PRAKTIKAVE MË TË MIRA NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR



Emri i Shërbimit

QENDRA DITORE "SHPRESA E RE"

Ofruesi i Shërbimit

Fondacioni OAZ

Informacioni Kontakti

Adresa: Lagja "Pjeter Budi" / Rruga "Ahmet Xhetani" nr. 14, Mat

Telefon: +355 (0) 692156500

Email: sajmirneziri@hotmail.com

Përshkrimi i Shërbimit

Qendra ditore "Shpresa e Re", ofron shërbime të specializuara dhe terapi të ndryshme për fëmijë e të rinj me aftësi të kufizuara të kategorive të ndryshme, me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e standarteve të tyre të jetesës. Qendra është e vetmja që ofron shërbime të tilla për këtë target grup në zonën Mat e Klos dhe i ofron ato pa pagesë. Qendra është e hapur çdo ditë për përfituesit nga ora 07.30 deri në orën 15.00. Disa përfitues që jetojnë në fshatra largohen pas konsumimit të drekës, ndërsa disa të tjerë vijnë në qendër në kohën e drekës pasi mbarojnë shkollën. Duke marrë në konsideratë kushtet e vështira ekonomike në të cilat jetojnë familjet e këtyre fëmijëve dhe të rinjve, përveç shërbimit psiko-social, përfituesve u ofrohet dreka dhe transporti pa pagesë, dhe u dërgohen pajisje ndihmuese në shtëpi, si karrige me rrota, materiale të ndryshme të cilat prindërit mund t'i përdorin gjatë kohës që fëmijët janë në shtëpi dhe lodra me qëllime terapeutike. Një vëmendje e

veçantë i kushtohet edhe punës me prindërit e përfituesve, të cilët vijnë shpesh pranë qendrës dhe shohin se si punohet me fëmijët e tyre për ta vazhduar programin edhe në shtëpi në të njëjtën linjë më atë që zhvillohet në qendër, me qëllim ruajtjen apo rritjen e mëtejshme të aftësive të nevojshme e të domosdoshme për fëmijët e tyre.

Historiku i zhvillimit të shërbimit

Qendra ditore "Shpresa e Re" është hapur në vitin 2008 dhe e ka filluar aktivitetin e saj me kapacitet të plotë në vitin 2011. Qendra është krijuar nga Fondacioni "OAZ", një organizatë humanitare e cila që prej vitit 1994 zhvillon aktivitetin e saj në ndihmë të grupeve në nevojë në Bashkinë e Matit. Puna në qendër filloi me një grup prej 10 fëmijë e të rinj me aftësi të kufizuara, numër i cili është rritur nga viti në vit falë rezultateve pozitive dhe besimit të krijuar në komunitet.

Profesionistët që ofrojnë shërbimin

Shërbimi ofrohet nga një staf i përbërë nga 12 punonjës: 1 punonjëse sociale e cila ka edhe një Master për mësuese mbështetëse, 2 psikologe, njëra prej të cilave ka edhe një Master për mësuese mbështetëse, 1 sociologe, 1 infermiere pediatër, 4 edukatore kujdestare, 1 kuzhinierë, 1 mirëmbajtës dhe 1 menaxher.

Inovacioni

Vetë ekzistenca e qendrës dhe puna e saj me fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara është një risi për zonën ku vepron. Fillimisht synimi kryesor i qendrës ishte që këta fëmijë dhe të rinj të dilnin jashtë "burgut" të shtëpisë dhe prindërit të kishin pak kohë për veten e tyre sepse dikush tjetër po kujdesej në mënyrë të sigurt për fëmijën. Sot qendra ofron shërbime të specializuara dhe ka ndryshuar jetën e shumë familjeve.

Avantazhet

Avantazhi kryesor i shërbimit është kombinimi i tij me shërbime të tjera që ofron Fondacioni "OAZ" për familjet e përfituesve të qendrës dhe grupeve të tjera në nevojë në

komunitet, si ndihmë financiare apo mbështetje me paketa ushqimore. Qendra njihet gjerësisht nga institucionet vendore dhe në nivel qarku, si dhe nga komuniteti i zonës për shërbimet dhe mbështetjen që ofron për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

Rezultatet

Një ndër rezultatet kryesore të shërbimit është thyerja e tabusë së zonës që një individ me aftësi të kufizuara është “një turp” dhe duhet të rrijë mbyllur në shtëpi. Më shumë se 200 fëmijë e të rinj me aftësi të kufizuara të moshave nga 2 deri në 30 vjeç nga qyteti dhe nga zonat përreth, me një numër mesatar prej 35-40 përfitues në vit kanë përfituar nga shërbimi që nga hapja e qendrës. Rreth 100 fëmijë apo të rinj sot nuk janë më pjesë e qendrës pasi një pjesë e tyre janë integruar plotësisht në shoqëri, 47 prej tyre ndjekin shkollën e zakonshme pa shfaqur vështirësi dhe vetëm 6 prej tyre vazhdojnë të ndiqen me mësues mbështetës.

Qëndrueshmëria

Qëndrueshmëria e shërbimit në këndvështrimin financiar sigurohet nëpërmjet mbështetjes nga Fondacioni “OASI” në Zvicër, i cili mbulon shpenzimet e mbarëvajtjes së qendrës ditore dhe pagesat e stafit. Një element i rëndësishëm i qëndrueshmërisë është mbështetja e ofruar nga Bashkia Mat, e cila me vendim të Këshillit Bashkiak i ka dhënë qendrës pa pagesë mjedisin për ushtrimin e veprimtarisë së saj deri në vitin 2028 dhe është angazhuar të paguajë një pjesë të shpenzimeve administrative të saj.

Bashkëpunimi me aktorë të tjerë

Qendra ka bashkëpunim të ngushtë me shkollat për koordinimin e punës për fëmijët që ndjekin shkollën dhe frekuentojnë qendrën dhe për ndarjen e informacionit e teknikave të mësimdhënies sa më efikase për fëmijët. Për t’u ardhur sa më shumë në ndihmë fëmijëve dhe familjeve të tyre janë krijuar ura bashkëpunimi me Komisionin Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), kurset e formimit profesional, bizneset lokale, qendrat shëndetësore, etj.

Mundësia për përsëritje

Shërbimi mund të zbatohet shumë thjeshtë edhe në zona të tjera. Në çdo bashki ekzistojnë apo mund të ngrihen godina që të shërbejnë si qendra ditore për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara, mund të përgatiten profesionistët që ofrojnë shërbimet dhe mund të punohet me bizneset lokale, të cilët me pak këmbëngulje dhe iniciativë kthehen në mbështetës dhe bashkëpunëtorë shumë të mirë.

KATALOGU

I PRAKTIKAVE MË TË MIRA

NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE

TË KUJDESIT SHOQËROR



Emri i Shërbimit

QENDËR KOMUNITARE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Ofruesi i Shërbimit

Bashkia Pogradec & Zyra Vendore Arsimore Pogradec

Informacion Kontakti

Adresa: Lagja 3, Rruga "Jovan Basho", Pogradec

Telefon: + 355 (0) 672640760

Email: anilabebri@yahoo.com

Facebook: Qendra Speciale Pogradec

Përshkrimi i Shërbimit

Qendra Komunitare Pogradec është qendër ditore për fëmijë dhe të rinj më aftësi të kufizuara. Qendra mirëpret fëmijë në moshë të hershme dhe ata që frekuentojnë ose jo institucionet arsimore. Shërbimet e ofruara synojnë mbështetjen e fëmijëve për të fituar autonominë vetjake dhe për t'u integruar sa më herët, butësisht dhe plotësisht në shkollat e zakonshme, kurse shërbimet për të rinjtë synojnë rritjen e shkallës së pavarësisë dhe aftësive të tyre okupacionale. Karakteristikë e modelit të shërbimit të ofruar në këtë qendër është kombinimi i mbështetjes intensive dhe afatgjatë arsimore me shërbimet aftësuese dhe riaftësuese fizike, okupacionale e komunikuese, të cilat ofrohen në grup ose individualisht. Koha mesatare e përfshirjes në shërbim është nga një deri në katër orë në

ditë, ndërsa kohëzgjatja dhe lloji i shërbimit ndryshojnë në bazë të nevojave të identifikuara të përfituesit. Prindërit e fëmijëve dhe të rinjve mbështeten me trajnime dhe sesione informuese me qëllim që ecuria e arritur në qendër të mirëmbahet dhe të vijojë në kushtet e shtëpisë. Qendra ofron trajnime mbi çështje teknike specifike edhe për mësuesit ndihmës të shkollave të zakonshme.

Profesionistët që ofrojnë shërbimin

Shërbimi ofrohet nga një staf multidisiplinar i përbërë nga 3 punonjës socialë (përfshirë një terapist të të folurit dhe një terapist fizik), 1 psikolog dhe 4 mësues, nën supervizimin e drejtueses së qendrës.

Historiku i zhvillimit të shërbimit

Historia e qendrës fillon në vitin 1994 me krijimin e klasave të arsimit special në varësi të Zyrës Arsimore Pogradec. Në vitin 2016, Bashkia Pogradec me mbështetjen e UNDP-së, modeloi shërbimet komunitare për personat me aftësi të kufizuara, duke riorientuar qëllimin e qendrës, duke shtuar tipologjinë e shërbimeve, duke shtrirë gjeografinë dhe zgjeruar gamën e përfituesve, pavarësisht statusit të tyre shkollor. Aktualisht, qendra funksionon me sukses në sajë të bashkëpunimit të ngushtë të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale të Bashkisë Pogradec me Zyrën Vendore Arsimore.

Inovacioni

Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta midis fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara me bashkëmohatarët e tyre jo më aftësi të kufizuara, bashkëpunimi i ngushtë me prindërit, me shkollat publike dhe me organizatat e shoqërisë civile janë mënyra të reja të punës që ka zbatuar qendra nga viti 2016 dhe që kanë pasur sukses për ndryshimin e mendësive, zbutjen e diskriminimit dhe rritjen e përfshirjes sociale të përfituesve në shkollat e zakonshme dhe në komunitet.

Avantazhet

Kultura e punës së stafit për të vlerësuar dhe zgjidhur nevojat e përfituesve duke u konsultuar sistematikisht me prindërit dhe aktorë të tjerë jashtë qendrës rrisin efektivitetin e shërbimit dhe krijojnë përparësi për qendrën.

Rezultatet

Që prej vitit 2016, qendra ka ofruar shërbime për 80 persona me aftësi të kufizuara, me një numër prej rreth 50 përfitues në vit. Përfituesit janë të grupmoshave të ndryshme (44 përfitues të grupmoshës 2-14 vjeç, 22 përfitues të grupmoshës 15-20 vjeç dhe 14 përfitues të grupmoshës mbi 20 vjeç), vijnë nga zona të ndryshme (37 përfitues nga zonat rurale dhe 43 përfitues nga zonat urbane) dhe nga grupe të ndryshme etnike (13 përfitues nga komuniteti rom dhe egjiptian). Shërbimi ka patur ndikim të drejtpërdrejtë tek personat me aftësi të kufizuara, pasi ka ndihmuar që ata të njohin të drejtat e tyre dhe si t'i kërkojnë ato, të përshtaten me jetën në komunitet, të krijojnë jetën e tyre sociale dhe të rrisin aftësitë për jetesë autonome dhe/ose të pavarur.

Qëndrueshmëria

Numri i përdoruesve të qendrës ka ardhur duke u rritur si pasojë e përmirësimit të cilësisë dhe shtimit të tipologjisë së shërbimeve, duke e bërë qendrën një institucion të rëndësishëm për familjet që kanë anëtarë me aftësi të kufizuara, si dhe një qendër burimore për mësuesit ndihmës të institucioneve të arsimit parauniversitar. Bashkëjetesa e suksesshme e shërbimeve të arsimit me shërbimet e kujdesit shoqëror ka përforcuar bindjen e aktorëve të interesuar për dobinë që kanë ndërhyrjet shumësektoriale për personat me aftësi të kufizuara dhe është garanci për vazhdimësi të këtij modeli shërbimi.

Bashkëpunimi me aktorë të tjerë

Qendra bashkëpunon ngushtësisht me aktorët lokalë publikë dhe jo publikë, përfshirë organizatat e shoqërisë civile në Pogradec, siç janë organizatat e personave me aftësi të kufizuara, shoqata "Unë Gruaja", shoqata "Gruaja Intelktuale", etj., për shkëmbimin e informacionit dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta që shërbejnë për aktivizimin dhe socializimin e përfituesve të saj.

Mundësia për përsëritje

Ky model shërbimi është efikas dhe lehtësisht i zbatueshëm në çdo njësi vendore ku shërbimet e kujdesit shoqëror dhe ato arsimore kanë vullnetin të bashkërendojnë dhe plotësojnë veprimtaritë e tyre.

KATALOGU I PRAKTIKAVE MË TË MIRA NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR



